



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 537 Akti

Nr. 578 Vendimi
Tiranë, më 26.10.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Pamela Qirko	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 25.10.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Eglantina Mikani**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit Eglantina Mikani, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) në datën 15.6.2020 zhvilloi procedurat e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjyqësore, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjyqësor i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Brunilda Bektoshi dhe Roland Ilia. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e parë të trupit gjyqësor të datës 19.6.2020 u caktua me mirëkuptim kryesues komisioneri Roland Ilia, si dhe u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjyqësor.

5. Në zbatim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të

Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka dokumentacion jo të plotë ligjor për të ardhurat e bashkëshortit;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin/raportet e mbajtur/a për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe në përfundim ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5 e nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret - vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale - vlerësoi se arrijnë nivelin e provueshmërisë dhe në datën 6.10.2022 vendosi: (i) përfundimin e hetimit paraprak për subjektin e rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40, 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit, në datën 6.10.2022 u njoftua nëpërmjet adresës elektronike, me anë të së cilës është kryer komunikimi gjatë procesit të rivlerësimit mbi të drejtën e saj për të

¹ Akti i përfundimit të kontrollit nr. *** prot., datë 12.4.2018.

paraqitur pretendime/shpjegime apo të kërkonte marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, duke i dhënë një afat të arsyeshëm deri në datën 14.10.2022 për të paraqitur shpjegimet dhe provat në lidhje me rezultatet e hetimit. Subjekti i rivlerësimit e ushtroi të drejtën për t'u njohur me dosjen, si dhe të marrë kopjen e saj elektronike në datën 10.10.2022.

16. Në datën 14.10.2022, përmes postës elektronike, subjekti i rivlerësimit kërkoi zgjatje të afatit për dërgimin e parashtrimeve dhe provave, kërkesë e cila u pranua nga trupi gjykues, duke vendosur shtyrjen e afatit për dërgimin e tyre deri në datën 20.10.2022, për të cilën u njoftua përmes postës elektronike².

17. Në datën 19.10.2022 subjekti i rivlerësimit ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe të provave të reja (nëpërmjet postës elektronike).

18. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vendosi ta ftojë³ në seancën dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail* në datën 25.10.2022.

II. SEANCA DËGJIMORE

19. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 25.10.2022, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

20. Subjekti i rivlerësimit Eglantina Mikani u paraqit personalisht dhe mori të gjithë kohën e duhur për të parashtruar shpjegimet në lidhje me procesin e rivlerësimit dhe rezultatet e hetimit administrativ. Në përfundim të shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë, me arsyetimin se ka arritur nivelin e besueshmërisë për të tria kriteret.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

21. Znj. Eglantina Mikani ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke iu përgjigjur në kohë pyetësorëve/kërkesave gjatë procedurës së hetimit administrativ, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

22. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

² Në datën 17.10.2022.

³ Subjekti u njoftua nëpërmjet adresës elektronike të datës 21.10.2022.

22.1. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit, objektivitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

22.2. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

22.3. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

22.4. Ndërsa në kreun VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

22.5. Por, referuar vendimit nr. 2/2017⁴ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22.6. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (e) denoncimet e publikut; (ë) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në Komision për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

⁴ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë sipas ligjit nr. 9049/2003.

23.1. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, duke e krahasuar me deklaratimet e interesave privatë dhe dokumentet shoqëruese, paraqitur më parë në këtë institucion, në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurive për subjektin e rivlerësimit.

23.2. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklaratimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara si burim krijimi të pasurive.

23.3. Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar (në vijim *Vetting*), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 30.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar përkatësisht pasuritë/të drejtat reale, si vijon:

24. Pasuria e paluajtshme e llojit “truall + ndërtesë”, në bashkëpronësi, e ndodhur në qytetin e Korçës, e regjistruar në ZVRPP me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe totale 102.50 m², nga e cila 71.70 m² ndërtesë. Pjesa takuese: 1/3 pjesë e pandarë e pasurisë.

24.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: *“Pjesa takuese në këtë pasuri prej 1/3 është fituar me trashëgimi, me vdekjen e të atit Ll.S në datën 25.12.2015. Me aktin noterial ‘dëshmi e trashëgimisë ligjore’ me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2016, jam njohur trashëgimtare ligjore në 1/3 pjesë të pasurisë së tij të pandarë”*.

24.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite

Në deklaratën e interesave private periodike vjetore (në vijim DIPP) të vitit 2016⁵, subjekti ka deklaruar: *“Pasuria e paluajtshme në bashkëpronësi e llojit truall + ndërtesë, e ndodhur në qytetin e Korçës, e regjistruar në ZVRPP-në Korçë me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe totale 102.50 m², nga e cila 71.70 m² ndërtesë”,* si dhe ka kryer të njëjtin deklaram si në deklaratën *Vetting* në lidhje me burimin e krijimit.

24.3. Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

➤ *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Korçë.*

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit lidhur me këtë pasuri

25. Nga administrimi dhe vlerësimi i dokumentacionit⁶ në lidhje me këtë pasuri, ka rezultuar se Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim ASHK), Drejtoria Vendore Korçë, konfirmon regjistrimin e kësaj pasurie në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit, nënës së saj M. S dhe

⁵ Dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI në datën 27.3.2017.

⁶ Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, i depozituar nga ILDKPKI-ja së bashku me raportin për kontrollin e pasurisë si ai i rezultuar nga hetimi i Komisionit me shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2020.

vëllait P.S, në pjesë takuese nga 1/3 secili, mbi bazën e dëshmisë për çeljen e trashëgimisë datë 9.3.2016⁷.

25.1. Pasuria, fillimisht, është përfituar me kontratën e shitblerjes⁸ datë 14.4.1969, sipas së cilës shtetasit Ll.Z dhe K.K i kanë shitur babait të subjektit Ll.S dhe vëllezërve të tij N.S dhe V.S, dy shtëpi bashkë me aksesorët e saj, me sipërfaqe ndërtese 151 m² dhe sipërfaqe oborri 139 m², të ndodhura në Lagjen Nr. ***, rruga “****” dhe rruga “****”, kundrejt çmimit 33,000 lekë.

25.2. Pasuria e blerë është pjesëtuar⁹ midis tre vëllezërve, ku nga analizimi i dokumentacionit duket se babai i subjektit ka përfituar gjithsej sipërfaqe takuese prej 109.60 m², mbi të cilën në vijim ka shtuar një papafingo me sip. 71.7 m², sipas lejes së ndërtimit datë 14.6.2002, të lëshuar nga Bashkia Korçë¹⁰, me objekt “Rikonstruksion dhe çati e shfrytëzueshme në rrugën ‘****’”. Pas përfundimit të ndërtimit, referuar dokumentacionit teknik¹¹, pasuria rezulton me sipërfaqe truall prej 102.53 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 71.70 m², e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

25.3. Me ndërrimin jetë të babait të subjektit dhe çeljes së dëshmisë së trashëgimisë ligjore¹², pasuria ka kaluar në favor të tre trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë, bashkëshortes së tij M.S, të bijës Eglantina Mikani dhe të birit P.S, në 1/3 pjesë takuese.

25.4. Për shkak të evidentimit të investimit për ngritjen e papafingos gjatë kohës së ushtrimit të detyrës si gjyqtare të subjektit të rivlerësimit¹³, Komisioni ka hetuar dhe gjithashtu e ka pyetur subjektin në lidhje me shpenzimet e kryera dhe burimet e krijimit¹⁴, ku pas administrimit të shpjegimeve të saj mbi mospasjen kontribut në investimin e kryer nga babai dhe pas verifikimit¹⁵ të faktit të shkëputjes së saj nga trangu familjar që nga data 10.11.1993, Komisioni ka çmuar të mos thellohet më tej, me arsyetimin se bazuar në nenin 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, babai dhe familjarët e saj nuk konsiderohen persona të lidhur me subjektin e rivlerësimit, për sa kohë nuk janë pjesë e së njëjtës certifikatë familjare me të dhe, për rrjedhojë, nuk bëhen objekt vlerësimi me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

25.5. Në përfundim, konkludohet se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ i Komisionit dhe se nuk evidentohen problematika në lidhje me këtë pasuri.

26. Pasuri e paluajtshme e llojit “truall”, në bashkëpronësi, e ndodhur në qytetin e Korçës, e regjistruar në ZVRPP me nr. *, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe totale 103.20 m². Pjesa takuese: 1/12 pjesë të saj.**

26.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar se pjesa takuese të kjo pasuri prej 4/48 (ose 1/12) është fituar me trashëgimi, me vdekjen e të atit Ll.S në datën 25.12.2015.

⁷ Nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2016.

⁸ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.4.1969, nga noteri V. P.

⁹ Me kontratë pjesëtimi vullnetar me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.7.1978, nga noteri J.L.

¹⁰ Leje ndërtimi sipas vendimit nr. ***, datë 14.6.2002, të KRRT-së Bashkia Korçë, si dhe dokumentacioni i ardhur nga Bashkia Korçë me shkresën nr. *** prot datë 4.7.2022

¹¹ Pjesë e dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Korçë me shkresën nr. *** prot., datë 4.7.2022.

¹² Trashëgimia ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2016.

¹³ Bazuar në të dhënat e dokumentacionit të tërhequr nga Bashkia Korçë me shkresën nr. *** prot., datë 4.7.2022.

¹⁴ Shihni pyetësorin nr. ***, pyetja nr. *** dhe pyetësorin nr. ***, pyetja nr. ***.

¹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 29.7.2022, e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

26.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite

Në DIPP-në e vitit 2016¹⁶, subjekti ka deklaruar: *“Pasuri e paluajtshme në bashkëpronësi e llojit ‘truall’ e ndodhur në qytetin e Korçës, e regjistruar në ZVRPP-në Korçë me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe totale 103.20 m², me burim krijimi pjesa takuese prej 4/48 (ose 1/12) është fituar me trashëgimi, me vdekjen e të atit Ll.S në datën 25.12.2015”.*

26.3. Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

➤ *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Korçë.*

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit lidhur me këtë pasuri

27. Nga hetimi i Komisionit¹⁷ është evidentuar se pasuria objekt vlerësimi është përfituar nëpërmjet trashëgimisë ligjore nga babai i subjektit Ll.S. Referuar dokumentacionit të administruar në lidhje me origjinën e kësaj pasurie, në fillim ajo ka qenë në pronësi të xhaxhait të subjektit, të ndjerit V.N.S, ku me ndërrimin jetë të tij dhe çeljes së trashëgimisë ligjore me vendimin nr. ***, datë 13.9.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, pasuria është ndarë midis vëllezërve dhe motrës së tij, përfshirë edhe babain e subjektit.

27.1. Në lidhje me këtë pasuri, pas administrimit të dokumentacionit u konstatua se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e rezultuar nga hetimi administrativ i Komisionit.

28. Pasuria e llojit “depozitë bankare” në shumën 3,311,020 lekë në “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të bashkëshortit të subjektit N.M. Pjesa takuese: 50%.

28.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është pasuri e fituar ndër vite, gjatë martesës, nga kursimet familjare.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

28.2. Nga verifikimi i deklaratave vjetore të pasurive ndër vite është konstatuar se subjekti ka kryer deklarime periodike në lidhje me ndryshimet që janë kryer me depozitën, si vijon: Në DIPP/2006¹⁸, *çelur depozitë në emër të Eglantina Mikani në datën 11.1.2007, në shumën 200,000 lekë, në “Raiffeisen Bank”.* Në DIPP/2008, *depozitë bankare në shumën 500,000 lekë, të depozituara në korrik të vitit 2008 në NBG Bank, dega Korçë, nga të cilat 300,000 lekë vijnë nga një depozitë e mëparshme e vitit 2007 në “Raiffeisen Bank”, dega Korçë.* Në DIPP/2009, *depozita bankare në NBG Bank, dega Korçë, është mbyllur në gusht të vitit 2009, shuma 500,000 lekë, plus 400,000 lekë është depozituar në “Tirana Bank”, dega Korçë. Deri më 31.12.2009 në këtë bankë ka pasur të depozituar shumën 950,000 lekë.* Në DIPP/2010, *depozita bankare në shumën 950,000 lekë në “Tirana Bank”, dega Korçë, ka kaluar në shumën 1,000,000 lekë deri më 31.12.2010. Është hapur një tjetër depozitë bankare në “Tirana Bank”, dega Korçë, në datën 11.4.2010, në shumën 100,000 lekë.* Në DIPP/2011, *depozita bankare në shumën 1,000,000 lekë në “Tirana Bank”, dega Korçë, ka kaluar në shumën 1,150,000 lekë deri më 31.12.2011. Depozita bankare në shumën 100,000 lekë në “Tirana Bank”, dega Korçë,*

¹⁶ Dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI në datën 27.3.2017.

¹⁷ Hetimi është përqendruar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, atij të depozituar nga ILDKPKI bashkë me raportin për kontrollin e pasurisë si atij të rezultuar nga hetimi i Komisionit me shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2020.

¹⁸ Duket se është deklaruar gabim nga subjekti në DIPP/2006, pasi depozita është çelur në datën 11.1.2007.

ka kaluar në shumën 150,000 lekë deri më 31.12.2011. Është hapur një tjetër depozitë bankare në "Tirana Bank", dega Korçë, në datën 16.12.2011, në shumën 100,000 lekë. Në DIPP/2012, depozita bankare në shumën 1,150,000 lekë në "Tirana Bank", dega Korçë, ka kaluar në shumën 1,250,000 lekë deri më 31.12.2012. Depozita bankare në shumën 150,000 lekë në "Tirana Bank", dega Korçë, ka kaluar në shumën 300,000 lekë deri më 31.12.2012. Depozita bankare në shumën 100,000 lekë në "Tirana Bank", dega Korçë, ka kaluar në shumën 200,000 lekë deri më 31.12.2012. Në DIPP/2013, depozita bankare në shumën 1,250,000 lekë në "Tirana Bank", dega Korçë, ka kaluar në shumën 1,350,000 lekë deri më 31.12.2014.

Depozita bankare në shumën 300,000 lekë në "Tirana Bank", dega Korçë, ka mbetur e pandryshuar në shumën 300,000 lekë deri më 31.12.2013.

Depozita bankare në shumën 200,000 lekë në "Tirana Bank", dega Korçë, ka kaluar në shumën 600,000 lekë deri më 31.12.2013. Në DIPP/2014, depozita bankare në shumën 1,350,000 lekë në "Tirana Bank", dega Korçë, ka kaluar në shumën 1,500,000 lekë deri më 14.1.2014, shtesa është kryer pjesërisht nga interesat bankare dhe diferenca nga të ardhurat e përfituara në vitin 2013. Depozita bankare në shumën 300,000 lekë në "Tirana Bank", dega Korçë, ka kaluar në shumën 400,000 lekë deri më 14.6.2014, shtesa është kryer pjesërisht nga të ardhurat e vitit 2014 dhe kursimet familjare. E mbyllur si depozitë në dhjetor të vitit 2014.

Depozita bankare në shumën 600,000 lekë në "Tirana Bank", dega Korçë, ka kaluar në shumën 700,000 lekë deri më 24.6.2014, shtesa është kryer pjesërisht nga të ardhurat e vitit 2014 dhe kursime familjare. E mbyllur si depozitë në dhjetor të vitit 2014. Në DIPP/2015, depozita bankare në shumën 1,500,000 lekë në "Tirana Bank", dega Korçë, është mbyllur në datën 14.1.2015, pas maturimit në vlerën 1,521,426 lekë dhe e tërhequr e gjithë shuma në datën 15.1.2015. Shuma e tërhequr nga kjo depozitë, si dhe ato të dy depozitave të tjera të mbyllura në po këtë bankë në dhjetor të vitit 2014 (shihni deklarinë e mëparshëm në shumën totale 1,108,200 lekë) së bashku me lekë të tjera gjendje cash në shtëpi (të deklaruara), kalojnë në datën 23.2.2015 si investime në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare tek "Intesa Sanpaolo Bank Albania" në emër të bashkëshortit N.M në shumën 3,000,000 lekë për ankandin që do të zhvillohej në datën 25.2.2015. Data e emetimit 26.2.2015 me maturim në datën 25.2.2016 dhe me interes 103,804 lekë. Në DIPP/2016, shuma prej 3,000,000 lekësh e kaluar në datën 25.2.2015 si investim në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare tek "Intesa Sanpaolo Bank Albania", e maturuar në datën 26.2.2016 në vlerë përfundimtare 3,088,233 lekë (pas shtesës së interesit të ndodhur në llogarinë rrjedhëse) ka kaluar si depozitë bankare tek "Intesa Sanpaolo Bank Albania" në datën 1.3.2016 në emër të bashkëshortit N.M, në shumën 3,300,000 lekë. Gjendja e depozitës është në shumën 3,311,020 lekë. Shtesa prej 212,000 lekësh është kryer nga kursimet familjare.

28.3. Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

➤ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e ardhura nga "Intesa Sanpaolo Bank", NBG Bank dhe DPPP.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

29. Nga hetimi i Komisionit¹⁹ në bankat e nivelit të dytë është evidentuar se subjekti ka kryer disa kreditime/debitime në llogaritë e depozitës gjatë vitit përkatës për periudhën 2006 – 2016, me gjendje balance në fund të vitit, pasqyruar në tabelën si vijon:

Tabela nr. 1

	Raiffeisien Bank	NBG Bank	Tirana Bank	ISP Bank
2006	150,000			
2007	200,000			
2008	-	500,000		
2009			950,225	
2010			1,100,000	
2011			1,400,000	
2012			1,751,889	
2013			2,250,000	
2014			1,500,000	
2015				3,103,804
2016				3,311,020

29.1. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarive konstatohet se përputhet deklarimi i subjektit në lidhje me gjendjen e llogarisë në deklaraten *Vetting* me dokumentacionin e rezultuar nga hetimi administrativ i Komisionit.

Analiza financiare në lidhje me mundësitë financiare të subjektit/personit të lidhur për të investuar në depozita ndër vite

30. Bazuar në deklaratimet e subjektit dhe dokumentacionin e administruar nga dosja e hetimit, Komisioni përgatiti analizën financiare paraprake për investimet në depozita për vitet 2006 – 2016. Nga kjo analizë duket se subjekti dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur mundësi për të përballuar me të ardhura të ligjshme investimet në depozita, krijimin e gjendjes *cash* dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera, duke rezultuar me pamjaftueshmëri financiare, përkatësisht: për vitin 2006 në shumën -275,388 lekë; për vitin 2007 në shumën -404,772 lekë; për vitin

¹⁹ (i) Shkresë nr. *** prot., datë 8.9.2020, e ABI Bank (ish-NBG Bank), protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 11.9.2020; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 16.9.2020, e “Raiffeisen Bank”, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.9.2020; (iii) shkresë nr. *** prot., datë 14.6.2022, e “Tirana Bank”, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 15.6.2022; (iv) shkresë nr. *** prot., datë 16.9.2020, e “Intesa Sanpaolo Bank”, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.9.2020.

2008 në shumën -396,516 lekë; për vitin 2011 në shumën 60,632 lekë; dhe për vitin 2013 në shumën -105,229 lekë, me një total pamjaftueshmërie financiare në shumën -1,242,537 lekë.

30.1. Mbi bazën e këtij rezultati financiar, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare në shumën -1,242,537 lekë, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

31. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e saj, ka prapësuar analizën financiare për secilin vit, duke pretenduar se me të ardhurat e përfituara dhe reduktimin e shpenzimeve, të cilat duhet të konsiderohen nga Komisioni, ajo dhe personi i lidhur me të do të kishin pasur mundësi financiare për të përballuar investimin në depozita, krijimin e gjendjes *cash* dhe përballimin e shpenzimeve të tjera të evidentuara gjatë hetimit, duke pretenduar për secilin vit si vijon:

Për analizën financiare të vitit 2006

31.1. Subjekti ka pretenduar se bashkëshorti ka përfituar të ardhura në këtë vit nga nëna e tij, nëpërmjet ushtrimit të aktivitetit tregtar së bashku me bashkëshorten e dajës së tij, regjistruar si person fizik me NUIS ***, “****”, me objekt “lojëra kompjuterash për fëmijë”, si dhe nga aktiviteti i ushtruar ekskluzivisht prej nënës së bashkëshortit, regjistruar si person fizik nën emrin “****”, me NUIS ***. Të ardhurat e përfituara i janë dhënë bashkëshortit të subjektit, për shkak të kontributit të tij në administrimin e aktiviteteve tregtare në lidhje me kryerjen e serviseve për kompjuterat, realizimin e marrëdhënieve me të tretët si dhe kryerjen e veprimtarive të tjera.

31.2. Sipas subjektit, të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i saj janë shtrirë për vitet 2006 dhe 2007, duke pretenduar shumën prej 180,000 lekësh për secilin vit, të cilat janë deklaruar në deklaratat përkatëse periodike, në deklaratën *Vetting* dhe gjatë hetimit të Komisionit në përgjigje të pyetësorëve. Në lidhje me këtë deklaram, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës një deklaratë noteriale²⁰ të datës 17.10.2022, të lëshuar nga shtetasja V. T, e cila ka deklaruar në lidhje me aktivitetin që ka pasur me nënën e bashkëshortit të subjektit, ku kanë investuar bashkarisht dhe se kjo e fundit ka qenë e punësuar në këtë aktivitet. Më tej, ajo ka deklaruar se aktivitetin e kanë ushtruar për periudhën 2004 – 2007 dhe administrimin e shoqërisë në raport me institucionet shtetërore e ka kryer bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit N. M.

31.3. Në analizën e të ardhurave për vitin 2006, subjekti ka pretenduar të përfshihen edhe të ardhurat e tjera nga paga e bashkëshortit në shoqërinë “****”. Konkretisht, ajo ka pretenduar se në këtë analizë të përfshihen jo vetëm të ardhurat e konsideruara nga Komisioni për periudhën shtator – dhjetor, por edhe të ardhurat për periudhën shkurt – gusht 2006, pasi sipas saj për këtë periudhë fakti që nuk ka listëpagesa në emër të kësaj shoqërie, detyrimi mbetet i punëdhënësit, jo i asaj, duke u mbështetur në vërtetimin mbi bazën e vlerësueshme datë 18.10.2022, paraqitur në cilësinë e provës. Pra, si përfundim, subjekti ka pretenduar të shtohen nga Komisioni edhe këto të ardhura, në total në shumën 98,000 lekë.

31.4. Gjithashtu, për efekt të analizës financiare, subjekti ka pretenduar në lidhje me reduktimin e shpenzimeve të qirasë ku është ushtruar aktiviteti i basteve sportive, duke prapësuar se këto

²⁰ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol.

shpenzime duhet të rillogariten nga Komisioni me gjysmën e shumës vjetore të qirasë së ambientit, duke qenë se bashkëshorti i saj për kryerjen e këtij aktivitetit ka pasur një marrëveshje verbale me shtetasin K.D, si bashkortak, të cilët kanë marrë përsipër që të gjitha shpenzimet, përfshirë edhe qiranë për ushtrimin e këtij aktivitetit, ta përballonin së bashku, në pjesë të barabarta takuese. Për të provuar këtë fakt, subjekti paraqiti në cilësinë e provës një deklaratë noteriale²¹ të datës 17.10.2022, të lëshuar nga shtetasi K.D, i cili ka deklaruar se ka pasur një aktivitet të përbashkët me bashkëshortin e subjektit në fushën e lotove sportive, me të cilin kanë ndarë bashkërisht investimin, shpenzimet dhe të ardhurat e përfituara që kur kanë marrë ambientin me qira e deri në fund të vitit 2013, kur kanë mbyllur këtë aktivitet. Si përfundim, subjekti ka pretenduar që shpenzimet e qirasë për vit të bëhen nga 90,000 lekë/vit në 45,000 lekë/vit.

31.5. Sipas subjektit, në analizën financiare të vitit 2006 duhet të përfshihet edhe një gjendje likuiditeti e papërdorur prej 318,000 lekësh, e cila ka qenë gjendje *cash* në fund të këtij viti, e krijuar nga mbyllja e dy depozitave në maj të vitit 2006 në NBG Bank në emër të bashkëshortit, përkatësisht, shumat 250,000 lekë dhe 550 euro, e konvertuar në shumën 68,000 lekë.

31.6. Në përfundim në lidhje me analizën financiare për vitin 2006, subjekti pretendon se ka përmbytur barrën e provës, duke rezultuar me balancë pozitive në shumën 47,612 lekë për këtë vit.

Për analizën financiare të vitit 2007

31.7. Në analizën financiare për vitin 2007, subjekti ka mbajtur pothuajse të njëjtin qëndrim si për vitin 2006, duke pretenduar se të njëjtat zëra të sqaruar për vitin 2006 duhet të reflektohen përkatësisht edhe për vitin 2007.

i) *Të ardhura të përfituara nga nëna e bashkëshortit në shumën 180,000 lekë* – sipas subjektit edhe për këtë vit ka vijuar e njëjta marrëdhënie tregtare e bashkëshortit me nënën dhe nusen e dajës së tij, sipas së cilës bashkëshorti ka siguruar të ardhura edhe për këtë vit në shumën 180,000 lekë nga nëna e tij, e cila ka qenë e punësuar ndër vite që prej vitit 2004. Këto të ardhura janë deklaruar edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007.

ii) *Të ardhura në shumën 200,000 lekë të kthyer si garanci e mbajtur nga shoqëria “***”* – subjekti ka pretenduar se në këtë vit i është kthyer edhe një shumë prej 200,000 lekësh, që përfaqëson gjysmën e shumës së garancisë, prej 400,000 lekë të vendosur në vitin 2005 në favor të kësaj shoqërie bashkë me ortakun K.D, për qëllime aktiviteti tregtar. Për të provuar këtë, subjekti referon si provë deklaratën noteriale të datës 17.10.2022, të lëshuar nga shtetasi K. D, i cili e konfirmon këtë fakt.

iii) *Ulja e shpenzimeve në shumën 45,000 lekë për investime dhe qira* – subjekti, edhe për këtë vit, ka pretenduar uljen e shpenzimeve deri në nivelin e shumës prej 45,000 lekësh për shkak të bashkortakërisë në fushën e basteve sportive me shtetasin K.D, marrëdhënia e së cilës është sqaruar edhe në analizën financiare të vitit 2006, si më lart.

²¹ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol.

31.8. Në përfundim në lidhje me analizën financiare për vitin 2007, subjekti pretendon se ka përmbysur barrën e provës, duke rezultuar me balancë pozitive në shumën 20,228 lekë për këtë vit.

Për analizën financiare të vitit 2008

31.9. Në analizën e vitit 2008 subjekti ka pretenduar se edhe për këtë vit duhet të reflektohet nga Komisioni ulja e shpenzimeve të qirasë në shumën 45,000 lekë me të njëjtën logjikë si në vitet 2006 dhe 2007.

31.10. Gjithashtu, për këtë vit, subjekti ka pretenduar se në rubrikën “shpenzime për arsim të bashkëshortit” duhet korrigjuar ky zë, duke sqaruar se pagesa e shkollimit në total ka qenë në shumën 200,000 lekë, i ndarë në 100,000 lekë paguar në vitin 2007 dhe 100,000 lekë paguar në vitin 2009, i shlyer totalisht në këtë vit dhe, për rrjedhojë, sipas saj, shënimi në deklaratën e vitit 2008 të pagesës së shumës prej 100,000 lekësh përfaqëson shpenzim të tepërt dhe prandaj duhet hequr.

31.11. Për vitin 2008, subjekti ka pretenduar edhe të ardhura nga aktiviteti privat “baste sportive”, të cilat, sipas saj, janë përfituar në formë komisionesh nga shoqëria “****” mbi bazën e xhiros së realizuar nga shitja e biletave për periudhën qershor 2008 deri në fund të vitit. Sipas subjektit të ardhurat e përfituara janë në shumën 140,000 lekë, të cilat janë deklaruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2008. Për të provuar marrëdhënien me këtë shoqëri dhe bashkëpunimin me të, subjekti paraqiti në cilësinë e provës *statement* - deklaratë e veprimeve bankare, datë 18.10.2022, të lëshuar nga “Credins Bank”, sipas së cilës pretendohet të provuarit e bashkëpunimit me punonjësit e kësaj shoqërie nëpërmjet veprimeve të ndryshme bankare.

31.12. Si përfundim, subjekti ka konkluduar se duke konsideruar pretendimet sa më lart, faktin e ardhjes në jetë të fëmijës së tyre të parë në fund të vitit 2007 dhe për rrjedhojë, uljen e shpenzimeve jetike për vitin 2008, si dhe krijimin e likuiditeteve të dhuruara nga të afërmit dhe shoqëria për shkak të këtij fakti, analiza financiare për vitin 2008 do të mund të rezultonte në balancë pozitive.

Për analizën financiare të vitit 2011

31.13. Në analizën financiare për vitin 2011, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar me të njëjtën logjikë si në vitet e mëparshme zërin “shpenzime për aktivitete baste sportive”, duke pretenduar se ky zë, edhe për këtë vit si në vitet e tjera, duhet të jetë në nivelin e shumës 45,000 lekë për shkak të bashkortakërisë në ndarjen e fitimeve dhe risqeve me shtetasin K.D dhe duke e provuar me të njëjtin akt sikundër cituar më lart, deklaratë noteriale të datës 17.10.2022, të lëshuar nga ky shtetas.

31.14. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në këtë vit duhet të llogaritet edhe një e ardhur tjetër e bashkëshortit të saj, përfituar si anëtar i KZAZ-së në zgjedhjet vendore të vitit 2011, për të cilën subjekti paraqiti në seancën dëgjimore, në cilësinë e provës, aktin vërtetim nr. ***, datë 24.10.2022, lëshuar nga Bashkia Korçë. Gjithashtu, në këtë vit, sipas subjektit, duhet të përfshihet edhe shpërblimi i përfituar për lindjen e fëmijës së dytë në fund të vitit 2010, i cili është përfituar për vitin 2011. Në lidhje me këtë pretendim, subjekti nuk paraqiti akt provues.

31.15. Në përfundim në lidhje me analizën financiare për vitin 2011, subjekti pretendon se ka përmbysur barrën e provës, duke rezultuar me balancë pozitive në shumën 29,368 lekë për këtë vit.

Për analizën financiare të vitit 2013

31.16. Si në çdo vit, edhe për këtë vit subjekti ka pretenduar të reduktohet shpenzimi i qirasë për ushtrimin e aktivitetit baste sportive deri në vlerën 45,000 lekë për shkak të përballimit të vlerës së qirasë bashkërisht me ortakun K.D gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies së qirasë.

31.17. Përveçse sa pretenduar në vitet e tjera, subjekti në analizën e këtij viti ka kërkuar që zëri “shpenzime për automjetin” në shumën 30,000 lekë, të deklaruar si shpenzim në deklaratën e pasurisë, të konsiderohet si pjesë e shpenzimeve jetike, duke arsyetuar se është pasaktësi deklarimi, pasi shpenzimi i kryer nuk përfaqëson ndonjë servis për automjetin, por është kryer për pagesa taksash të detyrueshme vjetore.

31.18. Si përfundim, subjekti ka konkluduar se nëse do të konsiderohen në këtë vit, sikurse edhe për vitet e tjera, të ardhurat e përfituara në formë komisioni në bazë të marrëveshjes që ka pasur bashkëshorti i saj me shoqëritë e basteve sportive, rezultati i analizës financiare do të ishte pozitiv.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

32. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për ndryshim të analizës financiare për vitet me balancë negative, shpjegimet dhe provat ku mbështeti kërkesën, si dhe pasi e dëgjoi në seancën dëgjimore, çmon se subjekti arriti të provojë pjesërisht të kundërtën e barrës së provës, duke sjellë për rrjedhojë edhe ndryshimet përkatëse në analizën financiare, për arsyet si vijon:

32.1. Në lidhje me të ardhurat e pretenduara nga bashkëshorti i subjektit për vitet 2006 dhe 2007, në total në shumën 360,000 lekë, të përfituara nga nëna e tij nëpërmjet aktiviteteve tregtare të ushtruara, përkatësisht me NUIS *** “*****” dhe NUIS *** “*****” dhe të dhuruara bashkëshortit të saj përgjatë viteve 2006 dhe 2007, trupi gjykues vëren se në deklaratat e pasurisë së kohës dhe në atë *Vetting* subjekti ka deklaruar:

- Në DIPP/2006: *“Të ardhurat e bashkëshortit N.M nga biznesi ‘lojëra me kompjuter’ të regjistruar në emër të V.T, ku zotëron 35% të fitimit lojëra rrjeti për fëmijë. Shuma: 300,000 lekë”.*

- Në DIPP/2007: *“Të ardhurat e bashkëshortit N.M nga biznesi i vogël ‘lojëra me kompjuter për fëmijë’ e regjistruar në emër të V.T, ku zotëron 35% të biznesit. Shuma: 180,000 lekë”.*

- Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar: *“Të ardhura të përfituara për vitet 2006 dhe 2007 nga bashkëshorti N.M në aktivitetin privat të regjistruar në emër të nënës së tij E.M (person fizik) me NIPT *** dhe në atë me NIPT ***, në shumën 360,000 lekë”.*

- Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit të parë, subjekti gjithashtu ka deklaruar se bashkëshorti i saj ka përfituar të ardhura si vijon: *“Të ardhura neto për vitet 2006 dhe 2007 nga bashkëshorti N.M në aktivitetet private me NIPT *** person fizik ‘***’ dhe NIPT *** person fizik ‘*** në shumën 180,000 lekë secili vit”.*

32.2. Më tej, nga analizimi i provave shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se referuar “vërtetimeve për bazën e vlerësueshme²²” lëshuar nga Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore Korçë për punëdhënësin “****”, person fizik, me NIPT ***, nëna e bashkëshortit të subjektit E.M ka përfituar të ardhura si punëmarrëse mbi të cilën është derdhur kontributi për periudhën janar – shtator 2005, në shumën totale 106,936 lekë dhe për periudhën janar – qershor 2006 në shumën totale 75,084 lekë. Ndërsa për periudhën korrik – dhjetor 2006 konstatohet se znj. E.M ka qenë e regjistruar me NIPT ***, person fizik, dhe se referuar “vërtetimit për bazën e vlerësueshme” për këtë periudhë ka përfituar të ardhura mbi të cilën është derdhur kontributi në shumën totale 78,840 lekë, në total për vitin 2006 ka përfituar të ardhura në shumën 153,924 lekë. Pra, duket se për periudhën e referuar, nëna e bashkëshortit të subjektit ka përfituar të ardhura nga punësimi si punëmarrëse pranë personit fizik “****” dhe si e vetëpunësuar, në total në shumën 260,860 lekë.

32.3. Për të konsoliduar deklarinimin e saj në deklaratat periodike të kohës për vitet 2006 dhe 2007 në lidhje me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i saj për shkak të kontributit të dhënë në aktivitetin tregtar familjar “lojëra kompjuterike për fëmijë”, subjekti paraqiti në cilësinë e provave dy deklarata noteriale, përkatësisht deklaratën noteriale²³ datë 7.9.2022, të lëshuar nga znj. E. M dhe deklaratën noteriale²⁴ datë 17.10.2022, të lëshuar nga znj. V. T, të cilat kanë deklaruar në lidhje me faktin e bashkëpunimit tregtar që kanë pasur që nga viti 2004 dhe kontributin e dhënë nga bashkëshorti i saj në themelimin dhe mbajtjen e këtij aktiviteti. Për më tepër, në deklaratën e lëshuar nga znj. E.M, ajo ka deklaruar në lidhje me të ardhurat e dhuruara bashkëshortit të subjektit të përfituara nga punësimi dhe fitimi për shkak të investimit të saj me 35% në vlerën e aktivitetit, që ka menaxhuar bashkërisht me shtetasen V.T, si dhe të ardhurat e përfituara nga vetëpunësimi dhe fitimi nga ushtrimi i aktivitetit të saj si person fizik.

32.4. Trupi gjykues, pasi vlerësoi deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në harmoni me njëra-tjetrën, si dhe provat e paraqitura, çmon se pretendimi i subjektit për përfshirjen në analizën financiare të viteve 2006 dhe 2007 të të ardhurave në shumën 360,000 lekë, të përfituara nga lojërat kompjuterike për fëmijë është pjesërisht i bazuar. Nga analizimi i provave shkresore të paraqitura nga subjekti rezulton se nëna e bashkëshortit të subjektit ka realizuar të ardhura nga punësimi, të cilat në periudhën më të afërt me deklarinimin e subjektit në vitin 2006, pra janar – shtator 2005, konsistojnë në shumën 106,936 lekë. Nën të njëjtën logjikë arsyetimi, edhe për vitin 2007 të dhënat e punësimit të nënës së bashkëshortit të subjektit i referohen periudhës janar – dhjetor 2006 me të ardhura të realizuara në total në shumën 153,924 lekë. Pra, rezultoi se nëna e bashkëshortit të subjektit ka realizuar të ardhura të ligjshme sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në total në shumën 260,860 lekë, të cilat u konsideruan në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, përkatësisht për vitin 2006 në shumën 106,936 lekë dhe për vitin 2007 në shumën 153,924 lekë, duke marrë për bazë deklarinimet koherente të subjektit në deklaratat e kohës dhe në deklaratën *Vetting*, si dhe provat e paraqitura në mbështetje të shpjegimeve.

32.5. Në lidhje me pretendimin e subjektit për përfshirje në analizën e vitit 2006 të të ardhurave të tjera të përfituara nga paga në shoqërinë “****” për periudhën shkurt – gusht 2006 në shumën

²² Për periudhat korrik – dhjetor 2004; janar – shtator 2005; janar – qershor 2006.

²³ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol.

²⁴ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol.

98,000 lekë, trupi gjykues, pas vlerësimit të shpjegimeve dhe provës, “vërtetim mbi bazën e vlerësueshme”, datë 18.10.2022, paraqitur prej saj për të provuar të kundërtën, e çmon atë të pabazuar, për arsyet si vijon. Në analizën financiare paraprake, Komisioni ka konsideruar si të ardhura të ligjshme nga punësimi i bashkëshortit pranë shoqërisë “****” të ardhurat e përfituara për periudhën shtator 2006 – nëntor 2007, në total në shumën 231,000 lekë, bazuar në vërtetimin mbi bazën e vlerësueshme të lëshuar nga Drejtoria e Arkivit të Rajonit Tiranë, paraqitur nga subjekti gjatë hetimit administrativ²⁵, si dhe riparaqitur²⁶ në formën e kërkuar nga ligji në mbështetje të pretendimeve përfundimtare.

32.6. Për sa i përket periudhës janar – gusht 2006, nuk provohet që bashkëshorti i subjektit të ketë përfituar të ardhura të ligjshme. Referuar vërtetimit mbi bazën e vlerësueshme, datë 18.10.2022, citohet se për periudhën e sipërcituar nuk administrohen lista për rrethet nga Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, por ky akt nuk provon se nuk ka listëpagesa në emër të shoqërisë “****” për këtë periudhë, sikurse pretenduar nga subjekti. Si përfundim, subjekti nuk arriti të provonte përfitimin e të ardhurave të ligjshme nga bashkëshorti i saj për periudhën janar – gusht 2006, sikurse provoi përfitimin e të ardhurave për periudhën shtator 2006 – nëntor 2007. Për rrjedhojë, zëri të ardhura nga paga në shoqërinë “****” mbeti i pandryshuar në analizën financiare për vitet 2006 dhe 2007.

32.7. Gjatë administrimit të shpjegimeve, Komisioni vuri re se subjekti është përpjekur të përfshijë në të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i saj edhe komisionet nga shitja e biletave të basteve sportive, duke shpjeguar se mbi bazën e marrëveshjeve që bashkëshorti ka pasur me shoqëritë sportive ai ka arritur të sigurojë një marzh të caktuar fitimi në varësi të shitjeve të realizuara. Si përfundim, subjekti ka pretenduar se Komisioni duhet të përfshijë në analizën financiare edhe të ardhurat e përfituara në formë komisionesh për vitet 2006, 2007 dhe 2008. Trupi gjykues çmon se edhe ky pretendim është i pabazuar, pasi subjekti nuk arriti të provojë në asnjë fazë të procesit të rivlerësimit në lidhje me marrëveshjet e arritura nga bashkëshorti i saj me shoqëritë e basteve sportive për ushtrimin e aktivitetit tregtar dhe realizimin e marzhit të fitimit nëpërmjet komisioneve të pretenduara për vitet përkatëse.

32.8. Në lidhje me pretendimin e subjektit për uljen e shpenzimeve të qirasë deri në gjysmën e vlerës totale të kontratës së qirasë për vitet 2006 – 2013, për shkak të bashkörtakërisë me shtetasin K.D në ushtrimin e aktivitetit, trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit dhe i vlerësoi ato me provat e paraqitura, vëren se:

32.9. Referuar kontratës së qirasë²⁷ datë 27.1.2006, të lidhur para noterit midis qiradhënësve A dhe Dh.P dhe qiramarrësve N.M dhe V.T, parashikohet marrja me qira bashkërisht nga të dy qiramarrësit e një ambienti dykatësh, çdo kat me sip. 30 m², kundrejt shumës 7,500 lekë/secili, shumë e cila, mbi baza vjetore, arrin në total 90,000 lekë/vit. Më tej, për të mbështetur pretendimin mbi përgjysmimin e shpenzimeve vjetore të qirasë, subjekti paraqiti në cilësinë e provës aktin deklarativ noteriale nr. *** rep., nr. ***, datë 17.10.2022, të shtetasit K.D, i cili ka deklaruar në lidhje me investimet e përbashkëta me bashkëshortin e saj në aktivitetet e basteve

²⁵ Në përgjigje të pyetësorit nr. ***.

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 19.10.2022, bashkëlidhur së cilës “vërtetim mbi bazën e vlerësueshme” nr. *** prot., datë 18.10.2022, lëshuar nga Drejtoria e Arkivit të Rajonit Tiranë.

²⁷ Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol.

sportive, si dhe për ndarjen e shpenzimeve të përbashkëta, duke cituar, ndër të tjera, edhe qiranë për vitet 2007 – 2010 për të njëjtin ambient të marrë më parë nga bashkëshorti i saj.

32.10. Trupi gjykues çmon se, duke u bazuar në praktikën e konsoliduar tashmë të Kolegjit²⁸, deklarata noteriale e datës 17.10.2022 e paraqitur nga subjekti në mbështetje të pretendimeve të saj ka vlerë të kufizuar provuese, për sa është hartuar pas kalimit të barrës së provës për të justifikuar reduktimin e shpenzimeve të qirasë dhe për sa nga ana tjetër nuk u provua me ndonjë akt të kohës marrëdhënies e përbashkët e qirasë e shtetasit K.D me bashkëshortin e saj. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit mbi reduktimin e shpenzimeve deri në shumën 45,000 lekë/vit mbetet i paprovuar.

32.11. Në lidhje me zërin “shpenzime qiraje”, trupi gjykues çmon përfundimisht se bazuar në deklaratimet e subjektit, si dhe në kontratën e qirasë datë 27.1.2006, si akt të kohës që vërteton marrëdhënien e qirasë së bashkëshortit të saj, shpenzimet e qirasë mbeten të pandryshuara në shumën 90,000 lekë/vit për periudhën 1.2.2006 – 5.5.2010. Ndërsa për periudhën 5.5.2010 – 2013 subjektit nuk i ngarkohen shpenzime qiraje, pasi bazuar në kontratën e qirasë datë 5.5.2010, të lidhur midis qiradhënësve Dh.P dhe A.C dhe qiramarrësve K.D dhe M.L rezulton se marrëdhënies e qirasë ka vijuar midis shtetasve të tjerë.

32.12. Subjekti, në shpjegimet përfundimtare, ka pretenduar të përfshihen në analizën financiare edhe gjendje likuiditeti tjetër, e krijuar përkatësisht: (i) për vitin 2006 nga mbyllja e dy depozitave në NGB Bank në maj të këtij viti në shumën 318,000 lekë; dhe (ii) për vitin 2007 nga heqja e garancisë së mbajtur në favor të shoqërisë “***” në shumën 200,000 lekë për qëllime aktivitetit tregtar. Trupi gjykues, në lidhje me këto pretendime, çmon se zëri “likuiditete” *cash* apo bankë është pasqyruar në analizën financiare bazuar në deklaratimet e subjektit, dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, si dhe atë të paraqitur prej saj dhe se pretendimet në lidhje me disponimin e likuiditeteve të tjera mbeten në nivel deklarativ.

32.13. Gjithashtu, në lidhje me të ardhurat e tjera, subjekti ka pretenduar të përfshihen në analizën financiare të vitit 2011 edhe të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i saj në zgjedhjet vendore të vitit 2011 si anëtar i KZAZ-së, duke paraqitur në seancën dëgjimore aktin vërtetim me nr. *** prot., datë 24.10.2022, lëshuar nga Bashkia Korçë, sipas të cilit citohet se z. N. M ka përfituar shpërblim *neto* në shumën 51,000 lekë si anëtar i KZAZ-së nr. *** në zgjedhjet vendore të vitit 2011. Trupi gjykues, pas vlerësimit të shpjegimeve dhe provës ku janë bazuar shpjegimet, çmon të përfshijë në analizën financiare të vitit 2011 të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti si anëtar KZAZ-je në shumën 51,000 lekë.

32.14. Në lidhje me pretendimet e subjektit për të përfshirë në shpenzimet jetike shpenzimet e përvitshme të automjetit, të deklaruara për vitin 2012 në shumën 40,000 lekë dhe për vitin 2013 në shumën 30,000 lekë, me arsyetimin se janë kryer si pagesa të detyrueshme vjetore (taksë, kolaudim) dhe prandaj duhet të zbriten nga shpenzimet përkatëse vjetore, trupi gjykues i vlerëson të pabazuara, pasi “shpenzimet jetike” përfaqëson një zë të veçantë në analizën financiare, referuar si *dyscheme*²⁹, përllogaritur sipas INSTAT-it mbi një mesatare të

²⁸ Shihni vendimet: nr. 6/2018 (JR), datë 12.9.2018; nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019; nr. 34/2019 (JR), datë 2.12.2019; nr. 23/2020 (JR), datë 25.9.2020; dhe nr. 11/2021 (JR), datë 31.3.2021, të Kolegjit.

²⁹ Shihni vendimin nr. 8/2021 (JR), datë 9.3.2021, të Kolegjit.

përgjithshme që përfshin edhe nivelin e varfërisë, bazuar në shpenzimet e përditshme jetike të qëndrimit dhe jetesës në Republikën e Shqipërisë dhe pagave mujore. Për rrjedhojë e kësaj analize, ky zë nuk përfshin asnjë shpenzim tjetër, qoftë periodik vjetor, përveç shpenzimeve të përditshme jetike.

32.15. Ndërsa, për sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit për heqjen nga analiza financiare e vitit 2008 të “shpenzimit për arsim bashkëshortit” në shumën 100,000 lekë, si shpenzim i deklaruar gabim, trupi gjykues e gjen të pabazuar këtë pretendim, për sa subjekti nuk e provoi me dokumentacion ligjor provues.

32.16. Trupi gjykues, pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit në lidhje me analizën financiare, zë më zë dhe në tërësi, çmon se ajo duhet ndryshuar për vitet, si vijon:

i) Për vitin 2006 balanca negative nga shuma -275,388 lekë arrin në shumën -168,452 lekë.

ii) Për vitin 2007 balanca negative nga shuma -404,772 lekë arrin në shumën -250,848 lekë.

iii) Për vitin 2008 balanca negative mbetet e njëjta -396,516 lekë.

iv) Për vitin 2011 balanca negative nga shuma -60,632 lekë arrin në vlera pozitive.

v) Për vitin 2013 balanca negative nga shuma -105,229 lekë arrin në shumën -15,229 lekë.

Rezultati financiar në total për vitet 2006 – 2013 nga -1,242,537 lekë arrin në shumën -831,045 lekë, i shpërndarë në 4 vite.

32.17. Trupi gjykues çmon se kjo balancë negative nuk është në atë nivel sa të passjellë penalizimin e subjektit të rivlerësimit për deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vlerësuar në optikën e parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, për shkak se subjekti ka arritur mjaftueshëm të përmirësojë situatën financiare, është përpjekur t’i provojë Komisionit nëpërmjet provave indirekte ushtrimin e aktivitetit tregtar të basteve sportive nga bashkëshorti i saj N.M dhe, për rrjedhojë, mungesa e burimeve të ligjshme në shumën -831,045 lekë, si e vetme, nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi, bazuar edhe në standardet e vendosura nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit³⁰.

³⁰ Shihni vendimet nr. 31/2020 (JR) dhe nr. 19/2022 (JR) të Kolegjit.

Tabela nr. 2

	2006	2007	2008	2011	2013
A) PASURI	766,044	755,482	525,665	195,560	578,689
Pasuri e paluajtshme në bashkëpronësi e llojit truall + ndërtesë e ndodhur në qytetin e Korçës, sip. totale 102.50 m2 nga e cila 71.70 m2 ndërtesë (1/3).					
Pasuri e paluajtshme në bashkëpronësi e llojit truall e ndodhur në qytetin e Korçës, sip. totale 103,2 m2. (1/12)					
Automjetet i markës ****; tipi ***, vit prodhimi 1994, me targa AA***					
Ndryshim likuiditeti	766,044	755,482	525,665	195,560	578,689
B) DETYRIME	0	0	0	0	0
Kredi pranë NBG Bank					
Kredi pranë Raiffeisen Bank					
C) PASURI NETO (A-B)	766,044	755,482	525,665	195,560	578,689
D) TË ARDHURA	1,098,770	1,289,709	1,053,099	1,167,728	1,513,744
Të ardhura nga paga SR	847,874	649,252	497,103	424,538	1,026,063
Të ardhura nga mësimdhënia SR	45,198				
Të ardhura nga leje ISSH SR	18,201	90,522	239,406	291,699	
Të ardhura nga paga bashkëshorti	24,561	221,011	301,745	364,394	381,697
Të ardhura nga shpërbllimi si anëtar I KZAZ				51,000	
Të ardhura nga nëna nga paga tek "Lojra në kompjuter për fëmijë"	106,936	153,924			
Të ardhura nga paga si I punësuar në shoqërinë ****	56,000	175,000			
Të ardhura nga aktiviteti privat baste sportive.					
Të ardhura nga interesat bankare			14,845	36,097	105,984
E) SHPENZIME	501,178	785,075	923,950	891,800	950,284
Shpenzime jetike	219,114	296,010	409,860	546,480	564,096
Shpenzim për aktivitetin baste (investim + qera)	90,000	90,000	90,000		
Shpenzime për këste kredie NBG Bank	149,064	149,065	144,090		
Shpenzime për këste kredie RFZ Bank				115,320	126,188
Shpenzime për arsim bashkëshorti		100,000	100,000	50,000	50,000
Shpenzime për automjetin					30,000
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	43,000				
Shpenzime për apartamentin me qira në Korçë		150,000	180,000	180,000	180,000
Balanca e fondeve (D-C-E)	-168,452	-250,848	-396,516	80,368	-15,229

33. Pasuri e llojit "likuiditet cash", në shumën 1,150,000 lekë, e padepozituar në bankë

33.1. Si burim krijimi të pasurisë subjekti ka deklaruar kursimet familjare gjatë martesës.

Deklarimi i pasurisë në vite

33.2. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore konstatohet se subjekti ka deklaruar gjendje cash duke filluar nga viti 2006, si vijon: (i) në DIPP/2006, gjendje cash e padepozituar në bankë 730,000 lekë; (ii) në DIPP/2007, gjendje cash e padepozituar në bankë në shumën 630,000 lekë si kursime familjare në këtë vit deklarimi; (iii) në DIPP/2008, gjendje cash e padepozituar në bankë, në shumën 1,600,000 lekë, kursime familjare në total, nga të cilat 1,500,000 lekë nga vitet e mëparshme dhe kursime 100,000 lekë nga ky vit, pra 2008; (iv) në DIPP/2009, gjendje cash e padepozituar në bankë në shumën 800,000 lekë; (v) në DIPP/2010 gjendje cash e padepozituar në bankë në shumën 950,000 lekë; (vi) në DIPP/2011, gjendje cash e padepozituar në bankë në shumën 1,000,000 lekë; (vii) në DIPP/2012, gjendje cash e padepozituar në bankë në shumën 1,200,000 lekë; (viii) në DIPP/2013, gjendje cash e padepozituar në bankë ka ngelur e pandryshuar në shumën 1,200,000 lekë; (ix) në DIPP/2014, gjendje cash e padepozituar në bankë në shumën 1,100,000 lekë. Këtu shtohet gjendja cash e rrjedhur nga mbyllja e dy depozitave të sipërcituara në muajin dhjetor 2014 në shumën 1,108,200 lekë. Pra, në total 2,200,000 lekë; (x) në DIPP/2015, gjendje cash e padepozituar në bankë në shumën 800,000 lekë; (xi) në deklaratën Vetting, gjendja cash ka qenë në vlerën 1,150,000 lekë; (xii) në DIPP/2016, gjendja cash e padepozituar në bankë në shumën 1,100,000 lekë.

33.3. Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

➤ Të ardhurat e realizuara ndër vite justifikojnë gjendjen cash të deklaruar.

Analiza financiare në lidhje me krijimin e likuiditeteve *cash*

34. Bazuar në deklaratimet e subjektit, dokumentacionin e administruar nga dosja e hetimit administrativ, Komisioni përgatiti analizën financiare paraprake në lidhje me mundësitë e subjektit dhe personit të lidhur me të për të krijuar gjendjen *cash* ndër vite.

34.1. Analiza financiare u krye për të njëjtat vite me investimet e kryera në depozita, duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka krijuar likuiditete *cash* dhe në bankë në të njëjtat vite. Nga analiza financiare paraprake për vitet 2006 – 2016 dukej se subjekti dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur mundësi financiare për të justifikuar plotësisht krijimin e likuiditeteve *cash* dhe depozitave bankare, si dhe mbulimin e shpenzimeve të deklaruara dhe ato të evidentuara nga Komisioni, duke rezultuar në të njëjtën pamjaftueshmëri financiare si në pasurinë depozita dhe, konkretisht: në vitin 2006 në shumën -275,388 lekë; në vitin 2007 në shumën -404,772 lekë; në vitin 2008 në shumën -396 516 lekë; në vitin 2011 në shumën 60,632 lekë; dhe në vitin 2013 në shumën -105,229 lekë, pra me një total pamjaftueshmërie financiare në shumën -1,242,537 lekë.

34.2. Mbi bazën e këtij rezultati financiar subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare në shumën -1,242,537 lekë, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

35. Duke qenë se barra e provës, e cila i kaloi subjektit në lidhje me rezultatin negativ, ishte e njëjtë për likuiditetet në depozita dhe *cash*, subjekti nuk paraqiti ndonjë pretendim konkret në lidhje me likuiditetet *cash*, por u mjaftua me argumentet e paraqitura më lart, tek pasuria depozitë bankare.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

36. Trupi gjykues, në lidhje me këtë pasuri, arrin në të njëjtin konkluzion si në pasurinë depozitë bankare, duke mbetur i njëjti rezultat financiar përfundimtar në shumën -831,045 lekë, rezultat i cili, duke u vlerësuar nën dritën e parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk e penalizon subjektin në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

37. Pasuritë e llojit “likuiditete” – në llogari bankare

37.1. Gjendje e llogarisë rrjedhëse (e pagës) e deklarueses Eglantina Mikani, në datën 30.1.2017, në “Union Bank”. Vlera: 50,262 lekë.

37.2. Gjendje e llogarisë rrjedhëse (e pagës) e bashkëshortit N.M në datën 30.1.2017, në “Raiffeisen Bank”. Vlera: 607 lekë.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

38. Nga hetimi i Komisionit³¹ konfirmohet ekzistenca e llogarive rrjedhëse të subjektit dhe personit të lidhur me të me burim nga paga e secilit, si dhe përputhet deklarimi i subjektit dhe personit të lidhur me të me rezultatin e hetimit, në lidhje me gjendjen e likuiditetit.

³¹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2020, e “Union Bank”, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 22.9.2020; shkresë nr. *** prot., datë 16.9.2020, e “Raiffeisen Bank”, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.9.2020.

39. Pasuria e llojit “automjet”, marka “****”, tip ***, vit prodhimi 1994, ngjyrë e zezë, aktualisht me targa AA *** (ndërsa në blerje KO ***). Vlera: 800,000 lekë në momentin e blerjes. Pjesa takuese: në bashkëpronësi me bashkëshortin.

39.1. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar kursime familjare kundrejt çmimit 800,000 lekë, nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.3.2009, nga shitësi T.H.

39.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite

Në DIPP/2009³², subjekti ka deklaruar: “Në muajin mars 2009 është blerë automjeti tip ‘****’, modeli *** kundrejt shumës 800,000 lekë, pasqyruar edhe në kontratën e shitblerjes së pasurisë me targa KO ***. Vlera: 800,000 lekë”.

39.3. Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri

➤ *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja.*

39.4. Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

Nga hetimi i Komisionit³³ konfirmohet se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar në pronësi automjetin me targa AA ***. Komisioni verifikoi dosjen e këtij automjeti, nga ku konstatoi se fillimisht automjeti është blerë në Gjermani në vitin 2001, më pas i është shitur shtetasit T. H, i cili, në vijim, me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.3.2009, ia shet bashkëshortit të subjektit. Nga verifikimi i dokumentacionit, në lidhje me këtë pasuri, nuk u evidentuan *indicie* për hetime të mëtejshme.

39.5. Analiza financiare për blerjen e automjetit

Bazuar në deklaratimet e subjektit³⁴ mbi burimet e krijimit, Komisioni përgatiti analizën financiare në lidhje me mundësitë financiare të subjektit dhe personit të lidhur me të, sipas së cilës rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për blerjen e tij me kursimet e deklaruara një vit më parë në deklaratën e pasurisë së vitit 2008, për sa në këtë deklaratë rezulton se ka deklaruar gjendje *cash* nga kursimet në shumën 1,600,000 lekë.

40. Pasuri e paluajtshme e llojit “apartament në përdorim”, me adresë: Lagjja Nr. ***, rruga “****”, nr. ***, k. ***, Njësia Administrative Korçë. Në lidhje me këtë pasuri subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se këtë pasuri e ka marrë me qira për banim kundrejt shumës 15,000 lekë/muaj nga shtetasit Zh dhe Dh.Th. Pasuria figuron e regjistruar në ZVRPP-në Korçë me nr. ***, vol. ***, f. ***.

40.1. Qiraja ka filluar që nga data 1.3.2007, fillimisht me kontratë verbale me pronaren S.N, me afat njëvjeçar, e ripërtërirë çdo vit, kundrejt pagesës 15,000 lekë/muaj dhe në vijim është lidhur para noterit kontratë qiraje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.1.2017, me qiradhënëse vajzën e saj, shtetasen Zh.Th, kundrejt po të njëjtës shumë prej 15,000 lekë/muaj.

³² Dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI në datën 13.1.2014.

³³ Shkresë nr. *** prot., datë 16.9.2020, e DPSHTRR-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 17.9.2020.

³⁴ Deklarimi në deklaratën *Vetting* dhe në pyetësorin nr. ***.

Deklarimi i kësaj pasurie në deklaratat e interesave periodike vjetore

40.2. Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri që në fillim të marrëdhënies në deklaratën e pasurisë së vitit 2007 e në vijim deri në deklaratën e vitit 2016, në të dhënat e adresës së banimit, si dhe nga vitet 2008 – 2016, ka deklaruar shpenzimet e qirasë në shumën 15,000 lekë në muaj/180,000 lekë në vit.

Verifikimet/hetimet e Komisionit në lidhje me këtë pasuri

41. Nga verifikimi i dokumentacionit, i paraqitur nga subjekti³⁵, evidentohet se kjo pasuri fillimisht ka qenë e regjistruar në pronësi të shtetasve S. B dhe N.N dhe më pas ka kaluar në pronësi të shtetasve Dh dhe Zh.Th (e bija). Nga vlerësimi i dokumentacionit nuk u gjetën *indicie* për hetime të mëtejshme.

41.1. Më tej, në kuadër të hetimit, Komisioni ka hetuar³⁶ në lidhje me ndonjë konflikt të mundshëm të subjektit me qiradhënësit, në vijim të të cilit³⁷ nuk rezultoi që subjekti të ketë shqyrtuar ndonjë çështje me palë ndërgjyqëse një nga qiradhënësit.

ÇËSHTJE TË TJERA

42. Gjatë hetimit administrativ Komisioni ka hetuar në lidhje me banesat në përdorim të subjektit të rivlerësimit të evidentuara nga Komisioni apo të deklaruara nga subjekti, në vijim të të cilit kanë rezultuar këto fakte:

43. Apartament në pronësi të prindërve të bashkëshortit N.M, në Korçë

43.1. Gjatë hetimit administrativ subjekti ka deklaruar³⁸ se ka përdorur disa muaj në vitin 2005 shtëpinë e prindërve të bashkëshortit në Korçë me adresë: Lagjja Nr. ***, rruga “****”, nr. ***, Korçë.

43.2. Në lidhje me këtë banesë ka rezultuar se figuron e regjistruar në emër të babait të bashkëshortit të subjektit, z. S.N.M, sipas certifikatës së pronësisë nr. ***, datë 14.2.2008. Nga administrimi i dokumentacionit³⁹ duket se shtëpia e banimit është ndërtuar në vitin 1993 mbi truallin e tij, bazuar në lejen e ndërtimit të miratuar me vendim të KKRT-së nr. ***, datë 5.11.1993, pra para lidhjes së martesës së subjektit të rivlerësimit me bashkëshortin. Komisionit nuk i rezultuan dyshime të mëtejshme në lidhje me këtë pasuri.

44. Ambient banimi i përdorur pa kundërshpërblim së bashku me bashkëshortin N.M, në bulevardin “**”, në Korçë**

44.1. Në kuadër të verifikimeve të Komisionit në lidhje me pasuritë në pronësi/përdorim, ka rezultuar se subjekti ka deklaruar⁴⁰ se për periudhën dhjetor 2005 – shkurt 2007 ka jetuar pa qira së bashku me bashkëshortin në një banesë në pronësi të kushërinjve të saj, R dhe E.K, me vendndodhje: bulevardi “****”, Korçë. Për të provuar deklarinimin subjekti ka paraqitur në

³⁵ Në deklaratën *Vetting* shihni Aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së dhe në përgjigje të pyetësorit nr. *** deklaratë notoriale³⁵ të datës 3.11.2016, kontratë qiraje³⁵ të datës 22.1.2017, të lidhur midis qiradhënëses Zh.Th dhe qiramarrëses E.M, me objekt dhënie me qira të një apartamenti me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 94.5 m², me vendndodhje në qytetin e Korçës në rrugën “****”, Lagjja Nr. ***.

³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 18.7.2022.

³⁷ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.7.2022.

³⁸ Pyetësori nr. ***, pyetja ***.

³⁹ Shihni dokumentacionin e dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 12.10.2020, nga ASHK Korçë.

⁴⁰ Në përgjigje të pyetësorit nr. ***.

cilësinë e provës deklaratorë notoriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.9.2020, lëshuar nga shtetasi R. K, dokumentacion për regjistrimin e pasurisë, çertifikatë për vërtetim pronësie dhe kartelë pasurie.

44.2. Komisioni administroi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, nga ku konstatohet se me deklaratorë nr. *** rep., *** kol., datë 1.9.2020, shtetasi R. K ka deklaruar se i ka dhënë pa kundërshpërblim kushërirës së tij banesën, në bashkëpronësi me vëllain e tij, për periudhën dhjetor 2005 – shkurt 2007, marrëdhënie të cilën nuk e ka formalizuar për shkak të lidhjes së afërt me subjektin. Ndër të tjera, ai ka deklaruar se shtëpinë nuk e disponon më, pasi e ka shitur në vitin 2007.

44.3. Referuar çertifikatës dhe kartelës së pasurisë, të lëshuar nga ASHK Korçë, datë 21.2.2007, konstatohet se pasuria trull me sipërfaqe totale 283.9 m², nga e cila 156.9 m² ndërtesë, e ndodhur në bulevardin “****” në Korçë është regjistruar në datën 5.6.2002, në bashkëpronësi të shtetasve E dhe R.K.

44.4. Nga të dhënat tregtare të publikuara në regjistrin e shoqërive tregtare⁴¹, shtetasit R dhe E.K rezultojnë të angazhuar në aktivitete tregtare me kapitale të konsiderueshme.

44.5. Në kuadër të hetimit, Komisioni ka hetuar⁴² për ndonjë konflikt të mundshëm interesi me shtetasit e sipërcituar. Nga hetimi⁴³ nuk u konstatua që subjekti i rivlerësimit të ketë shqyrtuar ndonjë çështje me shtetasit K apo shoqëritë ku ushtrojnë aktivitetin tregtar. Nga administrimi i fakteve dhe i dokumentacionit, Komisioni nuk evidentoi ndonjë interes të subjektit/personit të lidhur me të, në lidhje me pasurinë në përdorim dhe, për këtë arsye, nuk u thellua në hetime të mëtejshme.

45. Gjatë administrimit të informacionit bankar⁴⁴ është konstatuar e deklaruar nga subjekti në një dokument bankar adresa: rruga “****”, L. ***, nr. ***, Korçë. Komisioni e ka pyetur⁴⁵ subjektin në lidhje me këtë adresë, si dhe i ka kërkuar shpjegime në lidhje me të drejtat reale mbi pasurinë që i përket kësaj adrese.

45.1. Subjekti ka sqaruar⁴⁶ se që nga data 1.1.2021 ka filluar të banojë bashkë me familjen e saj në katin e dytë të një banese kolektive, të cilën e ka blerë me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.7.2021. Subjekti ka paraqitur të dhëna në lidhje me identifikimin e kësaj pasurie në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

45.2. Komisioni, më tej, aksesoi⁴⁷ të dhënat në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme, bazuar në nenin 50, pika 2, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, ku në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj rezultuan të regjistruara këto pasuri që nga data 6.8.2021: (i) apartament me nr. pasurie ***, me sipërfaqe totale 88.8 m² (me sipërfaqe të përbashkët 13.8 m² dhe sipërfaqe ballkoni 10.4 m²) e ndodhur në adresën: Bashkia Korçë, rruga “****”, ndërtesë nr. ***, shk. ***, ap. nr. ***, me vlerën 7,400,000 lekë, akti i fitimit të pronësisë me kontratë

⁴¹ <http://www.qkr.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>

⁴² Shkresë nr. *** prot., datë 18.7.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

⁴³ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.7.2022.

⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 14.6.2022, nga “Tirana Bank”.

⁴⁵ Shihni pyetësorin nr. ***.

⁴⁶ Shihni përgjigjen *** të pyetësorit nr. ***.

⁴⁷ Bazuar në nenin 50, pika 2, germa “c”.

shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.7.2021; (ii) bodrum me nr. pasurie ***, me sipërfaqe totale 16.72 (me sipërfaqe të përbashkët 4.03 m²) e ndodhur në adresën: Bashkia Korçë, rruga “***”, ndërtesë nr. ***, shk. ***, ap. nr. ***, me vlerë 100,000 lekë, akti i fitimit të pronësisë me kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.7.2021.

45.3. Gjatë hetimit administrativ të kryer, Komisioni ka konstatuar të deklaruar nga subjekti në pyetësorin e parë se me kontratën e porosisë së datës 15.7.2019 është porositur pranë shoqërisë sipërmarrëse “***” sh.p.k. apartamenti me sipërfaqe totale 113 m² (përfshirë edhe sipërfaqet e përbashkëta) dhe një bodrum me sip. 19 m², kundrejt shumës 7,500,000 lekë, duke paraqitur si dokumentacion mbështetës kontratën e porosisë. Nga administrimi i kësaj kontrate porosie është vënë re se pasuritë e porositura ndodhen në adresën: rruga “***”, me nr. ***, vol. ***, f. ***, pra në dukje adresë tjetër, nga adresa ku referohen pasuritë e blera nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2021. Në lidhje me këtë konstatim në dukje, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime, si dhe dokumentacion justifikues.

45.4. Subjekti shpjegoi bindshëm bazuar në prova⁴⁸ se është e njëjta pasuri që është porositur në vitin 2019 dhe, në vijim, e blerë në vitin 2021, duke sqaruar në dinamikë të gjitha rrethanat për ndryshimin e adresave për shkak të zhvillimit të ndërtimit në bazë të lejes së miratuar nga Bashkia Korçë.

ANALIZA FINANCIARE

46. Analiza financiare për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për vitet 2003 – 2016 është përgatitur nga Komisioni bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje gjatë hetimit administrativ, deklarimet e saj në ILDKPKI, si dhe në përgjigje të pyetësorëve të dhënë nga subjekti, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar kryerjen e investimeve, krijimin e gjendjes *cash* dhe përbalimin e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për vitet 2006, 2007, 2008, 2011 dhe 2013, duke rezultuar me pamjaftueshmëri financiare, përkatësisht: për vitin 2006 me balancë negative -275,388 lekë; për vitin 2007 me balancë negative -404,772 lekë; për vitin 2008 me balancë negative -396,516 lekë; për vitin 2011 me balancë negative -60,632 lekë; dhe në vitin 2013 me balancë negative -105,229 lekë, pra me një total pamjaftueshmërie në shumën -1,242,357 lekë. Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e pamjaftueshmërisë financiare të konstatuar.

46.1. Duke qenë se balanca negative e analizës financiare, për të cilën subjektit i kaloi barra e provës, konsistonte në investimet e depozitave dhe krijimin e gjendjes *cash*, subjekti paraqiti të njëjtat argumente dhe prova, të cilat u trajtuan nga Komisioni gjerësisht në seksionin e të dyja pasurive në këtë vendim. Në përfundim, duke pretenduar se nga analiza e të gjitha fakteve dhe provave dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit ajo ka ndryshuar balancën nga negative në pozitive, subjekti ka konkluduar se ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, bazuar në nenin 59, pika 1, germa “a”.

⁴⁸ Planvendosje e strukturës për banesë individuale (3 kate dhe bodrum) dhe vërtetim me nr. *** regj., datë 12.10.2022, sipas së cilës vërtetohet se znj. E. M është banuese në rrugën “***”, ndërtesa nr. ***.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

47. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit, argumentet për ndryshimin e analizës financiare, si dhe provat në mbështetje të shpjegimeve, çmon se subjekti i rivlerësimit arriti të prapësojë pjesërisht barrën e provës mbi pamundësinë financiare për të investuar në depozita, krijimin e gjendjes *cash*, si dhe përballimin e shpenzimeve të kryera ndër vite.

47.1. Nëpërmjet argumenteve dhe provave të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues arriti në konkluzionin e ndryshimit të balancës negative të analizës financiare nga shuma -1,242,537 lekë në shumën -831,045 lekë, e shpërndarë në 4 vite, balancë e cila, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk sjell pasoja penalizuese për subjektin e rivlerësimit sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për sa nga hetimi i Komisionit u evidentua se subjekti ka kryer deklaram të plotë dhe të saktë të pasurive, si dhe të drejtave reale, është përpjekur të justifikojë me dokumentacion ligjor burimet për krijimin e pasurive, si dhe veçanërisht të dokumentojë me prova indirekte krijimin e të ardhurave të bashkëshortit të saj nga aktiviteti i basteve sportive. Gjithashtu, nga hetimi i Komisionit nuk u evidentuan pasuri të fshehura apo të padeklaruara në emër të subjektit dhe/apo personit të lidhur.

47.2. Bazuar në argumentet sa më lart dhe duke e vlerësuar çështjen nën dritën e objektivitetit, trupi gjykues çmon se balanca negative e rezultuar nuk sjell impakt negativ në vlerësimin tërësor të komponentit pasuror dhe, për rrjedhojë, nuk mund të shërbejë si shkak i mëvetësishëm për t'u kualifikuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

47.3. Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, germa "a" e ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLI I FIGURËS

48. DSIK-ja, si organ kompetent ndihmës në procesin e rivlerësimit, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Eglantina Mikani, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

48.1. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, i ka dërguar Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës me nr. *** prot., datë 2.11.2017, i deklasifikuar plotësisht⁴⁹, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej saj në deklaramen për kontrollin e figurës; dhe (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera,

⁴⁹ Me vendimin nr. ***, datë 25.8.2022, të KDZH-së.

Grupi i Punës ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

48.2. Në vijim, DSIK-ja⁵⁰ ka dërguar raportin e përditësuar për kontrollin e figurës me nr. *** prot., datë 27.6.2022, deklasifikuar pjesërisht⁵¹, sipas të cilit bëhet me dije se:

- *Subjekti i rivlerësimit, referuar të dhënave, mund të ketë dhënë masën e sigurisë favorizuese për një të pandehur shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës.*
- *Informacionet e ardhura nga ana e autoriteteve verifikuese për subjektin e rivlerësimit Eglantina Mikani nuk janë sqaruar apo thelluar më tej dhe nuk kanë pasur vijueshmëri.*

Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Eglantina Mikani, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit.

Hetimi i Komisionit

49. Komisioni, pasi u njoh me raportin e përditësuar të DSIK-së dhe informacionet përkatëse, kërkoi⁵² dhe administroi praktikën gjyqësore përkatëse të tërhequr nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë. Nga shqyrtimi i kësaj çështjeje u konstatuan disa *indicie* për subjektin e rivlerësimit, të cilat u trajtuan në seksionin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale.

49.1. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni në kuadër të kriterit të kontrollit të figurës, nuk u evidentuan rrethana, të cilat mund të përbënin *indicie* për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

50. Në përfundim, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka deklaruar saktë dhe në përputhje me kërkesat e ligjit të dhënat e kërkuara në deklaratën e kontrollit të figurës.

50.1. Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

50.2. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Eglantina Mikani ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

⁵⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 1.9.2022.

⁵¹ Me vendimin nr. ***, datë 25.8.2022, të KDZH-së.

⁵² Shkresë nr. *** prot., datë 22.7.2022, e Komisionit dhe kthim përgjigje me nr. *** prot., datë 26.7.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

51. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përpiluar raportin për analizën e aftësive profesionale⁵³, i cili është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor me short; (iv) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

51.1. Referuar raportit të hartuar mbi bazën e kriterëve të vlerësimit sipas pikës 1 të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Subjekti i rivlerësimit ka aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor. Është efiçente dhe efektive në kryerjen e procedurave gjyqësore. Nga analizimi i dokumenteve objekt vlerësimi nuk janë konstatuar elemente që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit, si dhe nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të mos ketë respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme. Subjekti i rivlerësimit ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, shfaq sjellje etike dhe respekton të drejtat e palëve.

Rivlerësimi profesional nga Komisioni

52. Komisioni ka administruar dhe vlerësuar në mënyrë të pavarur dokumentet që kanë shërbyer si burim për kryerjen e vlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit. Nga vlerësimi i tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjeve të shortuara nuk u evidentuan *indicie* për subjektin e rivlerësimit, në kuptim të kriterit profesional.

52.1. Gjithashtu, në kuptim të kriterit profesional, Komisioni ka konsideruar dhe analizuar edhe ankesat e depozituara më parë në KLD⁵⁴ në lidhje me subjektin e rivlerësimit, nga të cilat është çmuar relevante ankesa e paraqitur nga shtetasi Kostandin Tona ndaj subjektit të rivlerësimit me objekt “shkelje procedurale në lidhje me vendosjen e një masë sigurim padie, në kundërshtim me nenin 202 të Kodit të Procedurave Civile”, për të cilën është konstatuar se KLD-ja ka propozuar nisjen e procedimit disiplinor për subjektin e rivlerësimit për shkaqe të parashikuara në nenin 32, pika 3, germa “a” dhe “gj” të ligjit nr. 7988/2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe në vijim ministri i Drejtësisë, si organ kompetent për nisjen e procedimit, nuk ka shprehur qëndrimin e tij në lidhje me propozimin e KLD-së.

52.2. Komisioni, bazuar në këto fakte, ka kërkuar⁵⁵ dosjen që lidhet me këtë çështje, nga administrimi⁵⁶ i së cilës kanë rezultuar faktet si vijon:

i) Në datën 16.4.2012 është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë padia e shtetasit K.T, ortak i shoqërisë “****” sh.p.k. kundër shoqërisë “****” sh.p.k., me administrator N.T, duke kërkuar, ndër të tjera: “*Konstatim pavlefshmërie absolute të vendimit të Asamblesë së*

⁵³ Raporti nr. *** prot, datë 18.5.2020.

⁵⁴ Të dërguara nga KLGJ-ja me shkresën nr. *** prot., datë 25.9.2020.

⁵⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 18.7.2022, drejtuar KLGJ-së.

⁵⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 25.9.2020.

*Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë ‘***’ sh.p.k. për shkarkimin e tij si administrator etj., si dhe përjashtimin e ortakut N.T nga shoqëria për shkak të kryerjes prej tij të veprimeve në dëm të interesave të shoqërisë’’. Gjithashtu, gjatë shqyrtimit gjyqësor nga i padituri si kundërvënie, është paraqitur edhe një kundërpadi me objekt ‘‘miratimi i kërkesës së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë ‘***’ sh.p.k. për përjashtimin e ortakut K.T nga shoqëria si pasojë e një veprimtarie të gjatë kundër interesave të shoqërisë dhe ortakëve të tjerë’’.*

ii) Gjatë seancës përgatitore, shoqëria ‘‘****’’ sh.p.k. ka paraqitur kërkesë për marrjen e masës së sigurimit të padisë me objekt ‘‘pezullim i të drejtës së votës në Asamblenë e Përgjithshme të ortakut K.T’’. Subjekti, pasi ka administruar provat e paraqitura nga kundërpaditësi dhe ka dëgjuar palët, me vendimin e datës 19.7.2012 ka vendosur: ‘‘Pranimin e kërkesës së të paditurit kundërpaditës për marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut K.T, vetëm për sa i përket miratimit të statutit të shoqërisë, deri në përfundimin e gjykimit të çështjes’’. Për marrjen e këtij vendimi subjekti, ndër të tjera, ka arsyetuar se marrja e masës paraqitet e nevojshme dhe e justifikuar, duke e pezulluar të drejtën e votës së ortakut K.T vetëm për sa i përket miratimit të statutit, për të lejuar ekzistencën e shoqërisë në treg, duke u bazuar, përveç nenit 202 të Kodit të Procedurës Civile edhe në nenin 230, pika 2, ku parashikohet se: ‘‘Shoqëritë tregtare, që kanë ekzistuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të detyruara të përshtatin organizimin dhe funksionimin e tyre, sipas dispozitave të këtij ligji, brenda 3 vjetëve pas hyrjes së tij në fuqi’’.

iii) Në vijim, mbi bazën e ankimit të paditësit është investuar Gjykata e Apelit Korçë, e cila pas shqyrtimit të ankimit me vendimin nr. ***, datë 7.11.2012, ka vendosur ndryshimin e vendimit datë 19.7.2012, duke rrëzuar kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të padisë, me arsyetimin se në marrjen e vendimit për marrjen e masës së sigurimit të padisë nuk janë respektuar kërkesat e nenit 202 të Kodit të Procedurës Civile dhe se vendimi është në kundërshtim me vendimin nr. 10/2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pasi çështja, me marrjen e masës së sigurimit të padisë, është zgjidhur në themel.

iv) Komisioni, bazuar në nenin 40 të ligjit nr. 84/2016 si dhe në nenin 71, germa ‘‘a’’ e ligjit nr. 96/2016, konstatoi disa *indicie* në vendimin e datës 19.7.2012 të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me vendosjen e masës së sigurimit të padisë, si vijon: (a) subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar kushtet për vendosjen e masës së sigurimit të padisë sipas nenit 202 të Kodit të Procedurës Civile; (b) në vendimin e dhënë nuk duket që subjekti të ketë arsyetuar nevojën emergjente për marrjen e kësaj mase, si dhe të ketë justifikuar dyshimin për ekzistencën potenciale të vështirësisë apo pamundësisë për ekzekutimin e të drejtave të paditësit me vendimin përfundimtar. Nga analizimi i vendimit nuk konstatohet risk në lidhje me prishjen e shoqërisë në rast të mosmiratimit të statutit, shkak ky i përdorur nga subjekti për të justifikuar nevojën për marrjen e masës, pasi vetë subjekti arsyeton në vendim se bazuar në nenin 230/2 të ligjit nr. 9901/2008, shoqëria ishte e detyruar të kryente këtë përshtatje përafërsisht deri para një viti dhe, për rrjedhojë, mospërshtatja me dispozitat e këtij ligji sjell pasojën ligjore prishjen dhe çregjistrimin e shoqërisë. Shoqëria, në momentin e shqyrtimit të kërkesës⁵⁷, nuk ka pasur ekzistencial riskun e prishjes, pasi bazuar në rrethanat e paraqitura ka qenë e detyruar ta kryente përshtatjen deri para një viti dhe, për rrjedhojë, duket se prishja e shoqërisë ka ardhur si pasojë

⁵⁷ Në datën 19.7.2012.

e moszbatimit të detyrimit ligjor të mospërshtatjes brenda afatit dhe jo për shkak të votës së ortakut. Pra, nuk duket që subjekti të ketë justifikuar vendosjen e masës për sigurimin e padisë me pezullimin e votës së ortakut; (c) subjekti nuk ka arsyetuar në lidhje me nevojën e vendosjes së një garancie nga kërkuesi në favor të palës tjetër, edhe pse është kërkuar nga ky i fundit; (ç) nga analizimi i vendimit për sigurimin e padisë, subjekti, gjithashtu, nuk ka respektuar vendimin unifikues nr. 10, datë 24.3.2004, të Gjykatës së Lartë, në të cilin përcaktohet se: *“Gjykatat, vendimin për marrjen e masës së përkohshme për sigurimin e padisë, nuk duhet ta mbështesin në fakte apo veprime, si dhe në cilësimin juridik të tyre, që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes në themel. Gjithashtu, shqyrtimi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë duhet të trajtohet në një mënyrë të tillë që të shmangë çdolloj perceptimi, sipas të cilit gjykata e ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes në themel apo nuk është e paanshme në gjykim”*. Mbi gjetjet e konstatuara subjektivit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

53. Subjekti ka paraqitur shpjegime shteruese dhe bindëse, si fillim në lidhje me rrethanat e çështjes, si dhe në vijim duke u ndalur në secilin prej konstatimeve të Komisionit. Në analizën e fakteve, ajo ka shpjeguar nevojën e marrjes së masës nëpërmjet pezullimit të votës së ortakut vetëm për miratimin e statutit të shoqërisë, me arsyetimin se shoqëria do të prishej. Subjekti ka arsyetuar se ekzistonin fakte të provuara me prova për vështirësinë e operimit të shoqërisë në treg. Në lidhje me vendosjen e garancisë ka shpjeguar se nuk ka qenë e nevojshme vënia e saj në favor të palës tjetër me arsyetimin se pezullimi i të drejtës së votës vetëm për miratimin e statutit nuk cenonte aspak të drejtat e palës tjetër, që rridhnin nga zotërimi i kuotës. Subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar gjithashtu se vendimi i dhënë prej saj nuk binte në kundërshtim me vendimin unifikues 10/2004, pasi kërkimi për sigurimin e padisë kishte disponim tjetër nga kërkimi në kërkesëpadi, si dhe provat dhe faktet që shoqëronin kërkesën për marrjen e masës nuk ishin të asaj natyre që lidheshin me zgjidhjen e themelit të çështjes. Si përfundim, ajo ka theksuar se nëpërmjet masës së vënë nuk ka zgjidhur themelin e çështjes, por ka realizuar qëllimin e kërkimit të masës, pasi ka rezultuar se pas marrjes së vendimit për masën e sigurimit është marrë vendimi për miratimin e statutit të shoqërisë, i cili është depozituar në QKR, duke paraqitur për këtë fakt edhe kopje të ekstraktit të shoqërisë, ku vihet re e shënuar se në datën 27.7.2012 është depozituar vendimi datë 23.7.2012 për ndryshimin e statutit, si dhe vendimi i gjykatës për marrjen e masës së sigurimit të padisë. Për të plotësuar argumentet e saj, subjekti ka shpjeguar edhe në lidhje me vendimin e themelit, duke i sqaruar trupit gjykues se në përfundim pas vlerësimit të çështjes, me vendimin përfundimtar datë 11.10.2013 ka disponuar për kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme.

53.1. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, çmon se subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë bindshëm dhe të provojë se ka arsyetuar mjaftueshëm nevojën e marrjes së masës për sigurimin e padisë sipas dispozitave ligjore në fuqi, si dhe bazuar në faktet dhe rrethanat e çështjes.

Gjetje të tjera

54. Gjatë hetimit administrativ për kontrollin e figurës është administruar dosja me *** regj., përfunduar me vendimin datë 25.8.2022, me objekt “vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi ndaj personit nën hetim Gj.Th”, për të cilin subjekti i rivlerësimit, pas shqyrtimit, ka disponuar me vendimin nr. *** regj., datë 25.8.2020, duke vleftësuar të ligjshëm arrestin në flagrancë për

të arrestuarin Gj.Th, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “organizim ose ushtrim i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin”, parashikuar në nenin 197/1 të Kodit Penal, si dhe duke caktuar masë sigurimi personal ndaj tij atë të “garancisë pasurore”, parashikuar nga neni 236 i Kodit të Procedurës Penale, me detyrimin për të depozituar një shumë prej 300,000 lekësh brenda 48 orëve në Degën e Thesarit Korçë, si dhe masë sigurimi “detyrim paraqitje në policinë gjyqësore”, dy herë në muaj.

54.1. Në lidhje me këtë çështje, Komisioni, pas analizimit konstatoi disa gjetje, për të cilat i kërkoi shpjegime subjektit, për sa duket se: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka arsyetuar nevojën e caktimit të masës së sigurimit “garancia pasurore”, parashikuar në nenin 236 të Kodit të Procedurës Penale, në raport me masën e sigurimit “arrest në burg”, të kërkuar nga organi i Prokurorisë; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk duket të ketë analizuar kushtet ligjore përcaktuese të shumës së garancisë pasurore, ku është bazuar sipas nenit 236, paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale, sikurse janë nevojat reale të sigurimit, rrethanat personale dhe familjare të të pandehurit, si dhe gjendja e tij financiare.

54.2. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi mjaftueshëm në lidhje me rrethanat e çështjes duke i analizuar ato. Ajo shpjegoi se në lidhje me caktimin e masës së garancisë pasurore ka marrë mendimin e palëve në seancë, si dhe është bazuar në rrethana të tjera të konstatuara gjatë hetimit të personit nën hetim. Në lidhje me vendimin e marrë subjekti ka theksuar se ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga organi i Prokurorisë, duke shpjeguar më tej se gjykata e ka zgjidhur themelin duke e vendosur përfundimisht në provë për një periudhë 16-mujore, bazuar në rrethanat e konstatuara si: rrezikshmëria e ulët shoqërore, rëndësia e faktit dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale.

54.3. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve, çmon se subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë bindshëm në lidhje me konstatimet e Komisionit se ka arsyetuar mjaftueshëm vendimin për caktimin e masës së sigurimit, si dhe në lidhje me faktet ku është bazuar për caktimin e shumës së garancisë pasurore ndaj të pandehurit.

55. Në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 10 denoncime⁵⁸. Nga administrimi dhe vlerësimi i secilit denoncim, në përputhje me nenin

⁵⁸ 1) Denoncim i shtetasit O.L, protokolluar me nr. *** prot., datë 4.1.2018, i cili ka denoncuar subjektin e rivlerësimit dhe një gjyqtar tjetër të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për vendime të padrejta; (2) denoncim i shtetasës F.M, protokolluar me nr. *** prot., datë 11.9.2020, e cila ka denoncuar subjektin e rivlerësimit, ndër të tjera, për mosmarrjen e vendimit të bazuar në ligj; (3) denoncim i shtetasit F.Q, protokolluar me nr. *** prot., datë 1.10.2021, i cili ka pretenduar sjellje joetike për subjektin e rivlerësimit; (4) denoncim i shtetasit P. D, protokolluar me nr. *** prot., datë 11.1.2021, i cili i kërkon KLGJ-së fillimin e procedimit disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit dhe disa magjistratëve të tjerë; (5) denoncim i shtetasës M.S, protokolluar me nr. *** prot., datë 11.10.2019, e cila ka denoncuar subjektin e rivlerësimit dhe prokurorin e çështjes për shkelje të ligjit lidhur me pagesat e ekspertëve në një çështje civile; (6) dy denoncime të shtetasit V. N, përkatësisht denoncim protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 30.4.2019, ku është denoncuar subjekti i rivlerësimit dhe një prokuror në Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe denoncim i po këtij shtetasi, përcjellë shkresërisht nga Institucioni i Komisionerëve Publikë me shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 13.7.2021, me objekt të dhënë në kundërshtim me ligjin; (7) denoncim të shtetasve R.K dhe B.H, protokolluar me nr. *** prot., datë 26.6.2019, të cilët kanë pretenduar për pakënaqësi në vendimmarrje; (8) denoncim i shtetasit K.K, protokolluar me nr. *** prot., datë 26.3.2018, me objekt “verifikim të shkeljeve”; (9) denoncim i shtetasës I. Z, protokolluar me nr. *** prot., datë 21.12.2021, e cila ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për kryerje të shkeljeve procedurale.

53 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me 4 prej tyre, në të cilat u evidentuan *indicie*. Subjekti paraqiti shpjegime, të cilat paraqiten në vijim në këtë vendim.

55.1. Komisioni, pasi administroi shpjegimet e subjektit dhe provat përkatëse, si dhe pasi i vlerësoi ato me objektivitet, çmon se subjekti i rivlerësimit ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse mbi gjetjet e konstatuara në trajtimin e problematikave të ngritura në denoncimet e publikut. Nga vlerësimi tërësor i tyre nuk vërehen rrethana që mund të përbëjnë shkelje procedurale të tilla që mund të çojnë në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

DENONCIMET

56. Denoncim nr. * prot., datë 1.10.2021, i shtetasit F.Q**

Ky shtetas ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka shfaqur etikë gjatë shqyrtimit të një çështjeje civile për një konflikt pronësie që ka pasur me nipin e tij E.Q, ku sipas denoncuesit e ka manipuluar gjykatën, duke arritur që subjekti ta mbyllë menjëherë gjyqin. Në lidhje me këto pretendime subjektit iu kërkuan shpjegime.

Subjekti ka shpjeguar se në çështjen me palë paditëse denoncuesin ka zbatuar me përpikëri rregullat e etikës në komunikim me palët, si dhe dispozitat e Kodit të Procedurave Civile. Subjekti ka sqaruar se ka qenë e detyruar të procedonte me kthim kërkesëpadie si të paplotë, pasi paditësi nuk kishte plotësuar padinë me aktet e nevojshme edhe pse kishin kaluar gati pesë muaj nga depozitimi i padisë në gjykatë dhe, për rrjedhojë, procesi është mbyllur me dy seanca gjyqësore. Në lidhje me pretendimin për palën e paditur, subjekti ka theksuar se pala tjetër, pra nipi që pretendon denoncuesi, në asnjë moment nuk ka kërkuar të marrë të drejtën e fjalës, por është përfaqësuar nga avokati i tij. Për të provuar shpjegimet e saj, subjekti i rivlerësimit paraqiti si provë kopje të vendimit nr. ***, datë 28.9.2021, në lidhje me këtë çështje, nga verifikimi i të cilit trupi gjykues i gjeti të mbështetura shpjegimet e subjektit.

57. Denoncim nr. * prot., datë 11.10.2019, i shtetases M.S**

Kjo shtetase ka denoncuar subjektin e rivlerësimit dhe prokurorin e çështjes ku, ndër të tjera, ka pretenduar se subjekti ka shkelur ligjin në lidhje me një çështje gjyqësore me pagesat e ekspertëve, duke dhënë urdhra të paligjshëm për vjelje nëpërmjet shërbimit përmbarimor, ndërkohë që shumat ishin në kundërshtim me ligjin. Ajo ka pretenduar se çështja duhej të mbyllej shpejt, ndërkohë që çështja është zvarritur për dy vjet dhe në fund subjekti i rivlerësimit ka dhënë dorëheqjen nga çështja. Në lidhje me këto pretendime subjektit iu kërkuan shpjegime.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në mënyrë shteruese në lidhje me faktet dhe rrethanat e çështjes gjyqësore civile me objekt “përmbushje detyrimi kontraktor për riparimin e plotë të automjetit tip ‘****’, me targa AA ***, duke e kthyer në gjendje të plotë funksionimi, të aftë për të qarkulluar në rrugë sipas parashikimeve të Kodit Rrugor”, ku denoncuesja ka qenë palë ndërgjyqëse. Në lidhje me këtë çështje, ajo ka shpjeguar se ka caktuar ekspert nisur nga natyra e kërkimit dhe pasi është deklaruar nga eksperti vlera e aktit, subjekti ka disponuar me vendim për ngarkimin e të dyja palëve me parapagim të shumës në 50% të vlerës/secili, për pagesën e së cilës subjekti ka qenë e detyruar ta njoftojë disa herë dhe shkresërisht denoncuesen dhe, në vijim, ka proceduar me vjeljen në mënyrë të detyrueshme të pagesës nëpërmjet shërbimit përmbarimor shtetëror. Në lidhje me pretendimin për zvarritje të procesit, subjekti ka shpjeguar

se menjëherë me hedhjen e shortit ka proceduar me shqyrtimin e padisë. Çështja ka zgjatur më pak se 8 muaj dhe shkak për shtyrjet ka qenë vetë denoncuesja, e cila nuk pranonte të kryente pagesën e ekspertit. Subjekti ka shpjeguar, gjithashtu, rrethanat e dorëheqjes nga çështja, duke e sqaruar trupin gjykues se ka qenë e detyruar të procedonte me kallëzim penal ndaj denoncueses për “fyerje ndaj gjyqtarit”, pasi ajo ka publikuar në rrjetin social *Facebook* fjalë fyese ndaj personit të saj. Në këto rrethana, subjekti ka bërë kërkesë për dorëheqje nga çështja, e cila është miratuar nga kryetarja e gjykatës. Me vendimin nr. ***, datë 17.5.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec denoncuesja është deklaruar fajtores dhe është dënuar për veprën penale “fyerje ndaj gjyqtarit”. Për të provuar shpjegimet, subjekti paraqiti prova⁵⁹, nga verifikimi i të cilave trupi gjykues i gjeti të mbështetura shpjegimet e subjektit.

58. Dy denoncime të shtetasit V.N., përkatësisht denoncim protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 30.4.2019, ku është denoncuar subjekti i rivlerësimit dhe një prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe denoncim i po këtij shtetasi, përcjellë shkresërisht nga Institucioni i Komisionerëve Publikë me shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 13.7.2021. Denoncuesi ka pretenduar se subjekti ka dhënë vendimin nr. ***, datë 15.2.2018, të mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili në kohën e ndodhjes së ngjarjes nuk ka ekzistuar. Në lidhje me këtë pretendim subjektit iu kërkuan shpjegime.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se pretendimi i denoncuesit nuk qëndron, pasi çështja objekt konflikti ka qenë zgjidhje e marrëdhënies së punës. Ajo ka shpjeguar se ligji, që referon denoncuesi, nuk ka qenë shkaku ligjor i konfliktit të palëve, por me ligjin “Për qeverisjen vendore” subjekti i është referuar në vendim (duke cituar faqen e vendimit) vetëm për sa i përket legjitimitetit të palës së paditur Bashkia Kolonjë në lidhje me kompetencat dhe shtrirjen e funksioneve të saj. Për të provuar shpjegimet, subjekti paraqiti si provë kopje të vendimit nr. ***, datë 15.2.2018, nga verifikimi i të cilit, trupi gjykues i gjeti të mbështetura shpjegimet e subjektit.

59. Denoncim nr. * prot., datë 21.12.2021, i shtetases I.Z**

Kjo shtetase ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për shkelje procedurale në lidhje me çështjen civile me objekt “konstatim pavlefshmëri absolute”, ku ajo ka qenë palë paditëse. Denoncuesja ka pretenduar se subjekti ka pushuar gjykimin edhe pse në seancën përkatëse të radhës ajo i kishte kërkuar shtyrje për shkak të shëndetit të të birit të ndodhur në Spanjë, të provuar me biletën e avionit. Denoncuesja ka pretenduar se nga pushimi i gjyqimit i janë shkaktuar kosto, pasi është detyruar ta rihapë sërish procesin gjyqësor. Komisioni, duke vlerësuar faktet në denoncim, ka administruar⁶⁰ dosjen gjyqësore me palë paditëse I.Z dhe të paditur E. H dhe H.M me objekt “pavlefshmëri kontrate qiraje”, ku pas verifikimit i ka kërkuar subjektit shpjegime në lidhje me pretendimet e denoncueses.

⁵⁹ Kopje të njësuara të akteve të shkëputura nga dosja civile nr. ***, datë 12.6.2018 (faturë tatimore e ekspertit, njoftime për tërheqjen e kopjeve të aktekspertimit drejtuar denoncueses, etj.), vërtetim i lëshuar nga kancelarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, si dhe kopje e vendimit nr. ***, datë 17.5.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

⁶⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.6.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në vijim të shkresës me nr. *** prot., datë 28.6.2022, të Komisionit.

Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime të plota dhe bindëse në lidhje me pretendimet e subjektit, duke sqaruar se çështja ka pasur dinamikë shtyrjesh të seancave për t'i dhënë mundësi denoncueses si palë ndërgjyqëse të ishte prezente dhe të ushtronte të drejtat e saj. Ajo ka sqaruar se bazuar në nenin 176 të Kodit të Procedurës Civile i ka lënë afat denoncueses për plotësimin e të metave për aktin e përfaqësimit. Subjekti ka theksuar se denoncuesja ka pasur të gjitha mundësitë që në momentin kur ka dërguar kërkesën në gjykatë në datën 14.11.2019 dhe ka njoftuar lidhur me shkakun e mosparaqitjes së saj të pajiste avokatin e çështjes me aktin përkatës të përfaqësimit për çështjen objekt shqyrtimi, duke e sqaruar trupin gjykues në lidhje me një fakt të ndodhur po në këtë datë, ku denoncuesja është paraqitur te noteri dhe ka përpiluar aktin e përfaqësimit, duke e pajisur avokatin e çështjes me prokurë të posaçme për një çështje tjetër me objekt pjesëtim pasurie. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve, i gjeti ato bindëse dhe nuk konstatoi problematika të mëtejshme.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, shkaqe këto që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

Trupi gjykues vlerëson se bazuar në sa më lart, subjekti i rivlerësimit Eglantina Mikani ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara prej saj, konkludon se subjekti ka arritur në mënyrë kumulative nivel të besueshëm në të tria kriteret:

- a. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. subjekti arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 4 pika 2 si dhe nenin 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Eglantina Mikani, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me nenin 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 26.10.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Pamela QIRKO
Relatore

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi

ANALIZA FINANCIARE PËRMBLEDHËSE

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
A) PASURI	200,001	-200,000	115,504	766,044	755,482	525,665	363,459	455,409	195,560	551,483	578,689	173,330	223,844	509,104
Pasuri e pajajshme në bashkëpronësi e llojit truall + ndërtesë e ndodhur në qytetin e Korçës, sip. totale 102.50 m2 nga e cila 71.70 m2 ndërtesë (1/3).														
Pasuri e pajajshme në bashkëpronësi e llojit truall e ndodhur në qytetin e Korçës, sip. totale 103,2 m2. (1/12)														
Automjet i markës ***, tip: **, vit prodhimi 1994, me targa AA***							800,000							
Ndryshim likuiditeti	200,001	-200,000	115,504	766,044	755,482	525,665	-436,541	455,409	195,560	551,483	578,689	173,330	223,844	509,104
B) DETYRIME	0	0	500,000	0	0	0	400,000	0	0	20,900	0	0	0	0
Kredi pranë NGB Bank			500,000											
Kredi pranë Raiffeisen Bank							400,000			20,900				
C) PASURI NETO (A-B)	200,001	-200,000	-384,496	766,044	755,482	525,665	-36,541	455,409	195,560	530,583	578,689	173,330	223,844	509,104
D) TË ARDHURA	662,467	830,521	779,026	1,098,770	1,289,709	1,053,099	1,369,480	1,410,474	1,167,728	1,611,041	1,513,744	1,712,843	1,909,372	1,886,953
Të ardhura nga paga SR	599,530	796,483	779,026	847,874	649,252	497,103	1,008,442	833,749	424,538	1,081,082	1,026,063	1,249,859	1,358,905	1,443,500
Të ardhura nga mësimdhënia SR	62,937	34,038		45,198										
Të ardhura nga leje ISSH SR				18,201	90,522	239,406		196,694	291,699					
Të ardhura nga paga bashkëshorti				24,561	221,011	301,745	310,069	341,354	364,394	375,269	381,697	426,301	425,237	432,517
Të ardhura nga shpërblymi si anëtar I KZAZ									51,000					
Të ardhura nga nëna nga paga tek "Loja në kompjuter për fëmijë"				106,936	153,924									
Të ardhura nga paga si I punësuar në shoqërië ***)				56,000	175,000									
Të ardhura nga aktiviteti privat baste sportive.														
Të ardhura nga interesat bankare						14,845	50,969	38,677	36,097	154,690	105,984	36,683	125,230	10,936
E) SHPENZIME	93,864	93,864	1,055,114	501,178	785,075	923,950	1,086,409	810,755	891,800	952,107	950,284	1,178,590	1,107,104	1,120,368
Shpenzime jetike	93,864	93,864	219,114	219,114	296,010	409,860	409,860	432,630	546,480	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzim për aktivitetin baste (investim + qera)			500,000	90,000	90,000	90,000	90,000	30,000						
Shpenzime për këste kredisë NGB Bank			-	149,064	149,065	144,090	288,684							
Shpenzime për këste kredisë RFZ Bank							17,865	118,125	115,320	118,011	126,188	118,598		
Shpenzime për arsim bashkëshorti					100,000	100,000	100,000	50,000	50,000	50,000	50,000		30,000	
Shpenzime për automjetin										40,000	30,000			
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit				43,000										
Shpenzime për apartamentin me qira në Korçë					150,000	180,000	180,000	180,000	180,000	180,000	180,000	180,000	180,000	180,000
Balanca e fondeve (D-C-E)	368,602	936,657	108,408	-168,452	-250,848	-396,516	319,612	144,310	80,368	128,351	-15,229	360,923	578,424	257,481